



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

www.qpz.gov.al

Nr.153

6 tetor

2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.1231, datë 2.7.2008	Për pagat e punonjësve mbështetës, në institucionet buxhetore, dhe të nëpunësve, në disa institucione buxhetore	7551
Udhëzim i MPPTT nr.13, datë 26.9.2008	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.994, datë 12.3.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e autoshkollave”, të ndryshuar ..	7566
Vendim i GJK nr.20, datë 29.9.2008	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.20, datë 7.4.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).....	7578
Vendim i GJK nr.21, datë 1.10.2008	Me objekt shfuqizimin e dekretit nr.5523, datë 22.11.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe të vendimit nr.141, datë 5.11.2007 të Kuvendit të Shqipërisë, si antikushtetues.....	7582

VENDIM
Nr.1231, datë 2.7.2008

**PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS, NË INSTITUCIONET BUXHETORE, DHE
TË NËPUNËSVE, NË DISA INSTITUCIONE BUXHETORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Klasat dhe nivelet e pagave të punonjësve, në disa institucione buxhetore, të cilët nuk trajtohen në pagë me strukturën e pagave të nëpunësve të shërbimit civil, caktohen sipas lidhjes nr.I, “Nivelet e pagës bazë për klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, të Kuvendit, institucione të tjera qendrore, në prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, me 10 klasa përkatësisht sipas lidhjes nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, të Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, dhe lidhjes nr.II “Nivelet e pagës bazë për klasë në institucionet e tjera”, me 14 klasa.

2. Pagat mujore të nëpunësve/punonjësve me tituj e grada shkencore, që janë efektivë me kohë të plotë, në universitete e shkolla të tjera të larta, në Akademinë e Shkencave, në qendrat spitalore universitare, në institutet dhe qendrat kërkimore e shkencore, që nuk janë reformuar ende, si dhe të funksionarëve, të papërfshirë në strukturën e pagave të nëpunësve të shërbimit civil, caktohen sipas lidhjes nr.III “Renditja e funksioneve me paga fikse”, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Pagat e punonjësve mbështetës në të gjitha institucionet buxhetore, në institucionet qendrore caktohen sipas lidhjes nr.I “Nivelet e pagës bazë për klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, të Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, me 10 klasa, sipas lidhjes nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, të Kuvendit, institucionet e tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, dhe sipas lidhjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

Për institucionet e tjera, sipas lidhjes nr.II “Nivelet e pagës bazë për klasë në institucionet e tjera”, me 14 klasa, dhe sipas lidhjeve përkatëse, të miratuara me urdhër të përbashkët.

4. Nëpunësve/punonjësve, pagat e të cilëve caktohen sipas lidhjes nr.I dhe lidhjes nr.II, pas çdo viti pune u jepet shtesë për vjetërsi në punë, 1 për qind mbi pagën bazë për klasë, por jo më shumë se 25 për qind. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë.

5. Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me titullarët e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, në bazë të klasave, të përcaktuara në lidhjen nr.II, caktojnë emërtimet e pozicioneve, sipas klasave, dhe shtesën për funksion drejtues (në ato raste kur ka funksione të tilla), sipas grupeve, për punonjësit e institucioneve të sistemit të tyre. Në rastet kur paga, për një pozicion të caktuar, mund të jetë nga një klasë më e ulët deri në një klasë më të lartë, titullarët e ministrive dhe të institucioneve të tjera qendrore, caktojnë pagat bazë për klasë, për pozicionet/emërtesën përkatëse.

6. Për punonjësit në funksione drejtuese jepet shtesë mbi pagën bazë për klasë, në përqindje, sipas shkallëzimit në 6 grupe, si më poshtë vijon:

Grupi i parë	deri në 5 %;
Grupi i dytë	5 deri në 10 %;

Grupi i tretë	10 deri në 15 %;
Grupi i katërt	15 deri në 20 %;
Grupi i pestë	20 deri në 30 %;
Grupi i gjashtë	30 deri në 40 %.

7. Për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, punonjësve, pagat e të cilëve caktohen sipas lidhjes nr.I dhe lidhjes nr.II, u jepen shtesa mbi pagë, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, si më poshtë vijon:

- Në shkallën e parë	deri në 5 %;
- Në shkallën e dytë	10 deri 15 %;
- Në shkallën e tretë	15 deri 20 %;
- Në shkallën e katërt	20 deri 25 %.

Këto shtesa, për të katër shkallët, llogariten mbi pagën bazë të klasës VI, të lidhjeve përkatëse, kurse për punonjësit e repartit të inspektim minierave, llogariten mbi pagën bazë mujore të klasës XI të lidhjes nr.II.

Ndarja e punëve, sipas shkallëve të vështirësisë e të dëmshmërisë, bëhet sipas lidhjes nr.IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Drejtoritë e shëndetit publik ose drejtoritë e higjienës dhe epidemiologjisë, në bazë të kriterëve të përcaktuara në lidhjen nr.IV, studiojnë vendet e punës dhe profesionet e vështira e të dëmshme për shëndetin dhe i propozojnë ministrisë apo institucionit qendror të sistemit të tyre, shkallën e dëmshmërisë e, njëkohësisht, edhe masën e shtesës mbi pagë.

Ministrinë dhe institucionet e tjera qendrore, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, miratojnë dhënien e këtyre shtesave për punonjësit e institucioneve dhe të ndërmarrjeve buxhetore të sistemit të tyre.

Kur punonjësit i takon të marrë dy a më shumë shtesa për vështirësi e dëmshmëri, ai do të marrë nga një vështirësi për çdo shkallë.

Këto shtesa u rekomandohen edhe punëdhënësve të tjerë të ndërmarrjeve e institucioneve jobuxhetore, shtetërore dhe private.

Punonjësit e sistemit të arsimit, që i kanë përfituar këto shtesa deri më 1 maj 1999 (me miratimin e strukturës së re të pagave, në sistemin e arsimit parauniversitar), do të vazhdojnë t'i përfitojnë ato, derisa të qëndrojnë në atë vend pune. Punonjësit, që fillojnë punë për herë të parë në arsim, nuk i përfitojnë këto shtesa.

8. Mjekët, që janë anëtarë të KMCAP-së (Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë në Punë) eprore dhe KMCAP-së në rreth, për punën, që bëjnë, marrin shpërblim në përqindje të pagës bazë mujore të mjekut, në masën, si më poshtë vijon:

- a) Për KMCAP-në eprore dhe KMCAP-të në rrethet e grupit të parë:
 - kryetari 36.5 për qind dhe anëtarët 31 për qind.
- b) Për KMCAP-në e rretheve të tjera:
 - kryetari 31 për qind dhe anëtarët 26 për qind.
- c) Punonjësit e ekspertizës mjekësore të punës, anëtarë të KMCAP-së marrin:
 - i) Për KMCAP-në eprore dhe për KMCAP-të e rretheve të grupit të parë:
 - 15 deri në 20 për qind të pagës, sipas klasës që kanë.
 - ii) Për KMCAP-të e rretheve të tjera:
 - 10-15 për qind të pagës, sipas klasës që kanë.

Masa e shpërblimit caktohet nga drejtuesi i institucionit.

9. Mjekët, që janë anëtarë të komisioneve mjeko-ligjore, për punën, që bëjnë, marrin shpërblim, në përqindje, të pagës bazë mujore të mjekut, në masën, si më poshtë vijon:

- a) Për komisionet mjeko-ligjore të rretheve të grupit të parë:
 - kryetari 17 për qind dhe anëtarët 15 për qind të pagës bazë mujore të mjekut.

- b) Për rrethet e tjera:
 - kryetari 15 për qind dhe anëtarët 12.5 për qind.

10. Punonjësve të sistemit shëndetësor, të cilët nuk trajtohen në pagë me vendimet e pagave të punonjësve me arsim të lartë, dhe punonjësve të infermieristikës, të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë e të Ministrisë së Mbrojtjes, për të siguruar gatishmërinë e shërbimit shëndetësor gjatë 24 orëve, për kryerjen e shërbimit të rojës dhe urgjencës, dhe punonjësve të repartit të inspektim-

shpëtimin në miniera, për kohën, që qëndrojnë në gatishmëri, u jepet një shpërblim deri në 15 për qind të pagës bazë mujore. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës caktojnë kriteret, rregullat dhe vendet e punës për dhënien e këtij shpërblimi.

11. Punonjësve të jashtëm, inxhinierë, ekonomistë, agronomë etj., që japin mësim në shkollat e mesme, në shkollat e ulëta profesionale dhe në kurset e ndryshme (me përjashtim të kurseve, që ngrihen pranë shkollave të larta dhe institucioneve të tjera të kualifikimit të punonjësve mësimorë), për çdo orë mësimore, u jepen 300 lekë.

12. Punonjësit e institucioneve e të organizatave ekonomike, qendrore e joqendrore, për të cilët bëhet fjalë në pikën 11 të këtij vendimi, për mësimet, që japin brenda kohës normale të punës, në kurset e kualifikimit, që organizohen nga institucionet e tyre përkatëse, nuk shpërblehen, kur orët e mësimin janë të barabarta me normën e arsimitarit për të njëjtën lëndë. Për orët suplementare paguhen sipas pikës 11 të këtij vendimi.

13. Punonjësit mësimorë efektivë, që, për nevoja të procesit mësimor japin orë mësimi mbi normën mësimore vjetore, të miratuar me aktet përkatëse, për çdo orë mësimi të kryer mbi këtë normë, paguhen, si më poshtë vijon:

a) Në universitete dhe shkolla të tjera të larta:

- punonjësit mësimorë efektivë, me titujt “Profesor” dhe “Profesor i asociuar” - 1 000 lekë për çdo orë 60-minutëshe;

- punonjësit mësimorë efektivë, me gradën shkencore “Lektor”, - 800 lekë për çdo orë 60-minutëshe;

- punonjësit mësimorë efektivë, “Pedagogë” dhe “Asistentë” - 500 lekë për çdo orë 60-minutëshe.

b) Në shkollat e mesme 300 lekë;

c) Në shkollat 9-vjeçare 250 lekë.

Punonjësit mësimorë në shkollat e larta, në sistemin me kohë të pjesshme, të cilët, për nevoja të procesit mësimor, japin orë mësimi jashtë kohës normale të punës, paguhen, për çdo orë mësimore, me 400 lekë në orë.

Punonjësit e jashtëm, që japin mësim në universitete dhe shkolla të tjera të larta, për çdo orë mësimi do të paguhen në të njëjtën masë me punonjësit efektivë, të këtyre institucioneve.

14. Për punonjësit efektivë, pedagogjiko-shkencorë e kërkimorë, në universitete dhe shkolla të tjera të larta, në Akademinë e Shkencave, në Akademinë e Mbrojtjes (punonjës pa grada, sipas sistemit të gradave të Forcave të Armatosura), dhe punonjësit efektivë, kërkimorë e shkencorë, në institutet dhe qendrat kërkimore-shkencore (të cilët nuk trajtohen me strukturën e pagave të nëpunësve civilë), si dhe në qendrat spitalore universitare, paga bazë mujore të jetë, si më poshtë vijon:

- Profesor A4;

- Profesor i asociuar A5;

- Lektor, punonjës kërkimor B1.

Kur këta punonjës caktohen në funksione drejtuese, përveç pagës përkatëse, marrin edhe shtesën, në përqindje, mbi këtë pagë, si më poshtë vijon:

Pozicioni	Shtesa në %
Rektor i universitetit të kategorisë I	25
Zëvendësrektor i universitetit të kategorisë I	20
Rektor i universitetit të kategorisë II	
Drejtues instituti	17
Sekretar shkencor i seksionit në Akademinë e Shkencave	
Zëvendësrektor i universitetit të kategorisë II	
Dekan	15

Zëvendës drejtor instituti Drejtor i qendrës kërkimore-shkencore Zëvendësdekan	13
Përgjegjës departamenti Përgjegjës qendre kërkimore	12
Përgjegjës shërbimi Kryetar seksioni në Akademinë e Shkencave	10
Përgjegjës seksioni Përgjegjës klinike Përgjegjës sektori	8

15. Punonjësve, që nuk janë efektivë të institucioneve të sipërpërmendura (të cilët nuk trajtohen me strukturën e pagave të nëpunësve civilë), por janë bashkëpunëtorë në veprimtaritë e këtyre institucioneve, u jepet shpërblimi mujor, si më poshtë vijon:

- Profesor 5 600 lekë;
- Profesor i asociuar 4 900 lekë;
- Për gradën shkencore “Doktor i shkencave” 4 200 lekë.

16. - Shoferët e titullarëve, të klasifikuar në grupin “A”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, që janë punonjës civilë dhe jo punonjës të Gardës së Republikës, përfitojnë pagë, sipas klasës VII të lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe 50 për qind shtesë mbi pagën bazë të klasës përkatëse.

- Shoferët e titullarëve, të klasifikuar në grupet “B” dhe “C”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, si dhe shoferi i kryetarit të Akademisë së Shkencave e shoferët e funksionarëve, të barazuar me ta në pagë, me ligje të veçanta, përfitojnë pagën sipas klasës VI të lidhjes nr.I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe 40 për qind shtesë mbi pagën bazë të klasës përkatëse.

- Shoferët e titullarëve, të klasifikuar në grupet “D” dhe “E”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, si dhe shoferët e titullarëve të tjerë, përkatësisht të zëvendësministrave, të drejtorit të kabinetit të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit dhe Kryeministrit, të sekretarëve të përgjithshëm në ministritë e linjës, të sekretarëve të përgjithshëm në institucionet e pavarura kushtetuese, të sekretarëve të përgjithshëm në institucionet e tjera të pavarura, të krijuara me ligje të veçanta, të prefektit të qarkut të Tiranës, të rektorit të universitetit, të titullarëve të institucioneve qendrore, në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit dhe në varësi të ministrave të linjës, të titullarëve të gjykatave të apelit, të gjykatave të apelit për krimet e rënda, të gjykatave të rretheve gjyqësore, të gjykatave për krimet e rënda, të drejtorit të Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor, përfitojnë pagën sipas klasës V të lidhjes nr.I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe 30 për qind shtesë mbi pagën bazë të klasës përkatëse.

17. Punonjësit, që përfshihen në njësitë ose drejtoritë e zbatimit të projekteve, kredive a ndihmave, që përfiton Republika e Shqipërisë nga institucione ndërkombëtare ose qeveri të vendeve të ndryshme, të trajtohen si pjesë e strukturave të ministrave të linjës.

18. Për natyrë të veçantë pune u jepet shtesë mbi pagën bazë mujore:

18/1 Punonjësve, të cilët punojnë me të sëmurë psikikë e me të meta mendore, në masën 15-20 për qind, sipas përcaktimit, që do të bëjë Ministri i Shëndetësisë.

18/2 Kryeinspektorit dhe inspektorëve sanitarë shtetërorë, epidemiologut dhe ndihmësepidemiologut, në strukturat e Institutit të Higjienës dhe Epidemiologjisë, Tiranë, deri në 20 për qind, sipas përcaktimit, që do të bëjë Ministri i Shëndetësisë.

18/3 Inspektorëve të Zyrës së Mbrojtjes nga Rrezatimet, 25 për qind.

19. Për një periudhë kalimtare, deri në zbatimin e plotë të pagave, sipas klasave dhe shtesave, që parashikon ky vendim, për pagesën e një pjese të punonjësve të institucioneve buxhetore, do të ndiqet kjo procedurë:

19.1 Të gjithë punonjësit, që trajtohen me këtë vendim, të cilët deri më sot janë në marrëdhënie pune në të njëjtin pozicion dhe janë paguar me një klasë më të lartë ose kanë përfituar një pagë bruto më të lartë nga sa parashikohet në këtë vendim, do të paguhën sipas lidhjeve të përcaktuara në këtë vendim dhe do të kompensohen me një shtesë page, në atë masë që paga bruto e tyre të mos

ulet në krahasim me nivelin e pagës së para datës 1 korrik 2008.

19.2 Të gjithë punonjësit, që trajtohen me këtë vendim, që kanë përfiturar deri para datës 1 korrik 2008 shtesa mbi pagë, të cilat nuk janë parashikuar në këtë vendim, do të vazhdojnë ta përfitojnë shtesën e pagës deri në atë nivel, ku paga e re dhe shtesat mbi pagë të barazohen me pagën bruto, së para datës 1 korrik 2008.

19.3 Punonjësit e emëruar pas daljes së këtij vendimi do të paguhën sipas lidhjes përkatëse të këtij vendimi.

19.4 Të gjitha shtesat mbi pagë, të cilat janë zbatuar deri më sot, do të rishikohen nëpërmjet një vendimi të veçantë, deri më 31 dhjetor 2008.

19.5 Ministrinë dhe institucionet qendrore do të raportojnë në mënyrë të hollësishme pranë Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Brendshme (Departamentit të Administratës Publike), brenda muajit tetor 2008, të gjitha strukturat dhe emërtesat, të cilat kanë përfiturar e vazhdojnë të përfitojnë një pagë më të lartë nga sa parashikon ky vendim.

20. Vendimi nr.726, datë 21.12.2000 i Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 korrik 2008.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, INSTITUCIONE TË TJERA QENDRORE, PREFEKTURA DHE SHËRBIMIN GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Nr.rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	17000
2	II	18500
3	III	19300
4	IV	19900
5	V	20500
6	VI	21600
7	VII	25000
8	VIII	28000
9	IX	31000
10	X	36000

Lidhja I/1

RENDITJA E POZICIONEVE TË PUNËS PËR ÇDO KLASË NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, INSTITUCIONE TË TJERA QENDRORE, PREFEKTURA DHE SHËRBIMIN GJEOLOGJIK SHQIPTAR

Nr.	Emërtimi i punonjësit	Niveli i pagës Klasa	Shtesë për funksion (grupi)
1	Drejtor drejtorie	X	6
2	Shef sektori Kryetar dege	IX	5
3	Përgjegjës zyre	IX	3
4	Specialist i parë Inspektor i parë	VIII	

	Sekretar i titullarëve të tjerë Përkthyes		
5	Specialist i dytë Inspektor i dytë Arkivist, protokollist Kryellogaritar Laborant në Institutin e Mjekësisë Ligjore Laborant në laboratorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve	VII	
6	Përgjegjës administrate Përgjegjës ofiçine e transporti	VI	1
7	Llogaritar i I-rë Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme Shifrant (MPJ)	VI	
8	Operator i terminaleve Llogaritar	V	
9	Shofer Magaznier Daktilografist Shaptilografist Fotokopjues Arkëtar Korrier diplomatik (MPJ) Shpërndarës shifre (MPJ) Spedicioner (MPJ)	IV	
10	Punëtor	II-IV	
11	Nëpunës informacioni	II	
12	Portier, pastrues, korrier Kafaz i salloneve të pritjes (MPJ)	I	

Lidhja I/2

NIVELET E PAGËS PËR PUNONJËSIT MBËSHTETËS NË PRESIDENCË, KUVEND,
KËSHILLIN E MINISTRAVE

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Përgjegjës arkivi Përgjegjës administrate	IX	4
3	Përgjegjës i teknikës së shumëfishimit, shtypshkrimit	VIII	3
4	Arkivist; llogaritar i parë, Operator, kameraman, fotograf; Magaznier	VIII	0
5	Përgjegjës ofiçine, parku	VII	1
	Punonjës shtypshkronje, shumëfishimi	VII	0

	Teknikë të ndryshëm Receptionist Magaznier Shofer-korrier		
6	Punëtorë të tjerë, shofer	VI	0
7	Punonjës pastrimi	III	0

Lidhja I/3

**EMËRTIME TË TJERA PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS SË GJYKATËS
KUSHTETUESE**

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Kryesekretar dhe sekretar seance	IX	
2	Sekretar i kryetarit	VIII	
3	Sekretare dhe indeksuese e legjislacionit	VII	

Lidhja nr.I/4

**NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS SË INSPEKTORATIT TË
KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË**

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Përgjegjës zyre	IX	5
2	Sekretar Teknik	VI	
3	Shofer i titullarit	V	
4	Shofer	IV	
5	Postier	I	

Shënim. Për emërtesa të tjera të punonjësve mbështetës, përdoret lidhja nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”.

Lidhja nr.I/5

**NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS SË GJYKATËS SË
LARTË**

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Sekretar i Kancelarit	C3	
2	Punonjës i ruajtjes së rendit	V-VIII	
3	Teknik mirëmbajtjeje Operator Magaznier	VII	
4	Shofer	V	
5	Punëtor pastrimi	III	

Shënim. Për emërtesa të tjera të punonjësve mbështetës, përdoret lidhja nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”.

**NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E ADMINISTRATËS SË PROKURORISË SË
PËRGJITHSHME**

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Sekretar i Përgjithshëm	A3	
2	Shef kabineti	A4	
3	Këshilltar Drejtor drejtorie	A5	
5	Zëdhënës shtypi Inspektor kontrolli Përkthyes Përgjegjës zyre	B5	
6	Specialist Jurist Sekretar i Prokurorit të Përgjithshëm	C2	
7	Oficer informacioni dhe i ruajtjes së rendit	VIII	
8	Teknik mirëmbajtjeje Operator Magaznier Arkëtar	VII	
9	Shofer Punonjës shërbimi	V	
10	Punëtor pastrimi	III	

Shënim. Për emërtesa të tjera të punonjësve mbështetës, përdoret lidhja nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”.

NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E AKADEMISË SË SHKENCAVE

Nr.	Emërtimi	Klasifikimi/paga
1	Kryetar i Akademisë së Shkencave	A1
2	Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave Sekretar Shkencor i Akademisë së Shkencave	A2
3	Akademik	A3
4	Profesor	A4
5	Profesor i asociuar	A5
4	Punonjës kërkimor	B1
5	Kërkues	B3

Shënim. Për emërtesa të tjera të punonjësve mbështetës, përdoret lidhja nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”.

**NIVELET E PAGËS PËR PUNONJËSIT MBËSHTETËS NË DREJTORINË E
PËRGJITHSHME TË ARKIVAVE TË SHTETIT**

ARKIVI SHTETËROR QENDROR

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Arkivist i dytë	VII	
2	Administrator dokumentesh	VI	
3	Laborant (mikrofilmues, restaurues, fotograf)	V-VI	

Shënim. Për emërtesa të tjera të punonjësve mbështetës, përdoret lidhja nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”.

Lidhja nr.I/9

**NIVELET E PAGËS PËR PUNONJËSIT MBËSHTETËS NË AGJENCINË TELEGRAFIKE
SHQIPTARE**

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Përgjegjës turni	VII	2
2	Teknik aparaturash	IV-V	
3	Radio-foto-teletajp	IV	
4	Laborant	VI	
5	Punëtorë të shtypit	III-IV	

Shënim. Për emërtesa të tjera të punonjësve mbështetës, përdoret lidhja nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”.

Lidhja nr.I/10

**NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT JOMËSIMORË TË UNIVERSITETEVE DHE
SHKOLLAVE TË TJERA TË LARTA, DHE PËR PUNONJËSIT CIVILË JOMËSIMORË TË
UNIVERSITETIT USHTARAK DHE AKADEMISË SË MBROJTJES**

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Sekretar i rektorit	IX	
2	Bibliotekar në bibliotekën shkencore të universitetit, me arsim të mesëm	VIII	
3	Bibliotekar në bibliotekat e fakultetit dhe Akademisë së Mbrojtjes, me arsim të mesëm Laborant me arsim të mesëm Restaurator me arsim të mesëm	VII	
4	Restaurator Laborant	VI	
5	Shofer i rektorit Preparator Ekonomist i mesëm	V	

	Kolektor Punonjës blegtorie		
--	--------------------------------	--	--

Shënim. Për emërtesa të tjera të punonjësve mbështetës, përdoret lidhja nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”.

Lidhja nr.I/11

NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E SHËRBIMIT GJEOLGJIK SHQIPTAR

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasifikimi
1	Drejtor i Përgjithshëm	B1
2	Zëvendësdyrejtor i Përgjithshëm	B3

PËR EMËRTESA TË TJERA

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Drejtor departamenti në Drejtorinë e Përgjithshme Drejtor në Institutin e Kërkimeve Gjeologjike Drejtor në Qendrën e Punimeve Gjeologjike	X	6
2	Zëvendësdyrejtor në Institutin e Kërkimeve Gjeologjike Kryeinxhinier në Qendrën e Punimeve Gjeologjike Drejtor departamenti në Institutin e Kërkimeve Gjeologjike Drejtor i departamentit të Gjeofizikës, të Hidrogeologjisë, të Gjeokimisë-Gjeoambientit dhe Gjeologjisë Inxhinierike, të Analizës së Lëndëve të Para Minerale, të Punimeve Topografike Shef sektori në Drejtorinë e Përgjithshme	X	5
3	Drejtor i degës rajonale Përgjegjës i Arkivit Qendror të Gjeologjisë Përgjegjës i Muzeut të Shkencave të Tokës	X	4
4	Përgjegjës sektori në njësinë Kërkimore Aplikative	X	1
5	Drejtues teknik, drejtues projekti në njësitë kërkimore-aplikative Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme	IX-X	
6	Inxhinier i specialiteteve të gjeologjisë Inxhinier i specialiteteve të ndryshme Financier Ekonomist Revizor Jurist Fizikan Informaticien Përpunues dokumentacioni	VIII	

	Matematicien Arkivist Punonjës biblioteke Punonjës muzeu Përkthyes Laborant me arsim të lartë		
8	Teknik gjeolog Teknik i specialiteteve të ndryshme Laborant me arsim të mesëm Operator Ekonomist Llogaritar Përpunues dokumentacioni Kompjuterist Heliografist Disenjator Kopist Arkëtar Magaznier Arkivist Punonjës biblioteke Punonjës muzeu protokollues	VI-VII	
9	Punëtor (mjeshtër shpimi, sondist, minator, armator, mekanik, motorist, elektrikist, tornitor, saldator, axhustator, llamarinist) Shofer	IV-VII	
10	Ndihmëssondist Ndihmësminator Ndihmësarmator Marangoz Murator	I-IV	

Shënim. Për emërtesa të tjera të punonjësve mbështetës, përdoret lidhja nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”.

Lidhja nr.I/12

NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT MBËSHTETËS TË QENDRËS KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Elektricit. Fonist	VI	
2	Butaforist. Piktur ekzekutues (me arsim të mesëm)	V	
3	Punëtor skene Garderobier	III	
4	Rojë	II	

Shënim. Për emërtesa të tjera të punonjësve mbështetës, përdoret lidhja nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”.

Lidhja nr.I/13

**NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT MBËSHTETËS TË GALERISË KOMBËTARE
TË ARTEVE, MUZEUT HISTORIK KOMBËTAR, MUZEUT TË ARTIT MESJETAR KORÇË,
MUZEUT “ONUFRI” BERAT, MUZEUT “GJERGJ KASTRIOTI SKENDËRBEU” KRUJË DHE
FOTOTEKËS KOMBËTARE “MARUBI” SHKODËR**

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Llogaritar i parë Ekonomist	VI	
2	Piktor me arsim të mesëm Skulptor me arsim të mesëm Restaurator me arsim të mesëm	VI	
3	Ndihmësrestaurator	V	
4	Vëzhgues salle Ruajtës fondesh Fototekist Katalogues	IV	
5	Punëtor restaurimesh	II-IV	
7	Biletashitës Pastrues Portier Korrier	I	

Shënim. Për emërtesa të tjera të punonjësve mbështetës, përdoret lidhja nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”.

Lidhja I/14

**NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT MBËSHTETËS TË BIBLIOTEKËS
KOMBËTARE**

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Kryellogaritar	VIII	
2	Ndihmësbibliotekar	VII	
3	Restaurator	VI	

Shënim. Për emërtesa të tjera të punonjësve mbështetës, përdoret lidhja nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”.

Lidhja nr.I/15

**NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT MBËSHTETËS TË QENDRËS SË
PUBLIKIMEVE ZYRTARE**

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Përgjegjës i sektorit të teknikës	X	5
2	Ofsetist	X	
3	Teknik shtypshkronje, faqosës	IX	

Shënim. Për emërtesa të tjera të punonjësve mbështetës, përdoret lidhja nr.I/1 “Renditja e

pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”.

Lidhja nr.I/16

**NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË REPARTIT TË
INSPEKTIM-SHPËTIMIT NË MINIERA**

Nr.	Emërtimi/pozicioni	Klasa e pagës	Shtesa për funksion drejtues
1	Specialist me arsim të mesëm në: - Laboratorin e provave të litarëve të çelikut - Emergjencën dhe shpëtimin - Mirëmbajtjen (kolaudimin) e pajisjeve shpëtuese - Mirëmbajtjen dhe kolaudimin e automjeteve	IX	0
2	Specialist me arsim të mesëm për komunikimin, informacionin dhe ruajtjen e institucionit Shofer i automjeteve të gatishmërisë	VII	0
3.	Shofer	V-VI	0
4	Operator gatishmërie .Magaznier	V	0
5	Punëtorë	II-IV	
6	Rojë objekti. Pastruese	I-III	

Shënim. Për emërtesa të tjera të punonjësve mbështetës, përdoret lidhja nr.I/1 “Renditja e pozicioneve të punës për çdo klasë në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, institucione të tjera qendrore, prefektura dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”.

Lidhja nr.II

NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË INSTITUCIONET E TJERA

NR. RENDOR	KLASA	Paga bazë mujore në lekë
1	I	17000
2	II	18500
3	III	19300
4	IV	19900
5	V	20500
6	VI	21200
7	VII	21850
8	VIII	22430
9	IX	23000
10	X	24500
11	XI	26200
12	XII	27100
13	XIII	28500
14	XIV	34000

Lidhja nr.III

RENDITJA E FUNKSIONEVE ME PAGA FIKSE

A1	Kryetar i Akademisë së Shkencave	162.850
A2	Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave Sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave	129.000
A3	Akademik	117.000
A4	Profesor Këshilltar i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura	103.500
A5	Profesor i asociuar Këshilltar i Kryetarit të Gjykatës së Lartë Këshilltar i Prokurorit të Përgjithshëm	89.250
A6		82.000
B1	Lektor Punonjës kërkimor	77.000
B2		74.000
B3	Pedagog Kërkues Rektor (pa titull/gradë shkencore)	66.500
B4	Asistent në shkollat e larta	58.500
B5	Përgjegjës zyre në Prokurorinë e Përgjithshme Inspektor kontrolli në Prokurorinë e Përgjithshme Përkthyes në Prokurorinë e Përgjithshme	48.300
C1		43.000
C2	Informaticien në Gjykatat e shkallës së parë dhe në gjykatat e apelit	39.000
C3	Sekretar i Kancelarit të Gjykatës së Lartë	33.700

Lidhja nr.IV

KRITERE PËR DHËNIEN E SHITESËS MBI PAGË PËR PUNË TË VËSHTIRA E TË DËMSHME PËR SHËNDETIN

Në zbatim të pikës nr.7 të këtij vendimi, ndarja e punëve sipas shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për shëndetin është si vijon:

1. Në shkallën e parë përfshihen punët që kryhen:

a) në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të pluhurave, që nuk shkaktojnë dëmtime të mushkërisë;

b) në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të substancave toksike, që nuk depozitohen në organizëm;

c) në ambientet e mbyllura, në të cilat për arsye teknologjike mbahet konstante temperatura mbi 25 gradë, ose nën 10 gradë;

d) në një ambient të lagët me lagështi relative të ajrit mbi 80 për qind, në baltë ose në kontakt direkt me ujë;

e) në kushtet e ekspozimit ndaj rrezatimit ultraviolett ose infra të kuqe, për shembull saldimi, farkëtimi etj;

f) në kushtet e vibrimit të përgjithshëm;

g) në ambientet në të cilat është i domosdoshëm përdorimi i ndriçimit artificial;

gj) pranë monitorëve elektrikë me ekran (kur punon mbi 4 orë në ditë).

2. Në shkallën e dytë të dëmshmërisë për shëndetin ose të vështirësisë së veçantë përfshihen punët që kryhen:

a) në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të pluhurave që shkaktojnë dëmtime të mushkërisë;

b) në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të substancave toksike që depërtohen në organizëm;

c) në kushtet e ekspozimit ndaj zhurmave;

d) në kushtet e presionit të ulur ose të ngritur për arsye të procesit teknologjik;
e) në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të vibrimit lokal, p.sh. përdorimi i pajisjeve pneumatike me dorë;

f) në kushtet e një mbingarkese fizike të llogaritur të paktën 1100 kilokalori për burrat dhe 600 kilokalori për gratë ose që kërkojnë një pozicion të detyruar për trupin;

g) në praninë efiçente potencialisht me burime infeksioni të rrezikshme, në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të hormoneve dhe antibiotikëve që shkaktojnë çrregullime të veprimtarisë fiziologjike të organizmit, si dhe faktorëve të tjerë me veprim të njëjtë si hormonet dhe antibiotikët, në qoftë se kjo do të njihet nga Instituti i Higjienës dhe Epidemiologjisë.

3. Në shkallën e tretë të dëshmërisë për shëndetin ose vështirësisë përfshihen punët që kryhen:

a) në kushtet e ekspozimit ndaj veprimit të fushave elektromagnetike me frekuencë të lartë në intervalin nga 0,1 deri 300.000 MhZ në zonën e rrezikut;

b) në kushte veçanërisht të rrezikshme:

- në lartësinë mbi 2m ose në thellësinë nën 2m kur punohet në prani të rrezikut;
- që lidhen me prodhimin, përdorimin, magazinimin dhe transportimin e gazeve dhe materialeve shpërthyes;

- brenda rezervuarëve, aparateve, kanaleve, puseve etj., kryerja e të cilave kërkon leje speciale nga drejtuesi i ndërmarrjes ose institucioni;

- në pajisjet elektroenergjetike që ndodhen nën tension mbi 220 V, që kryhen në përputhje me udhëzimet për mbrojtjen në punë;

- që lidhen me ngarkimin dhe shkarkimin e lëndëve djegëse të lëngëta, si dhe transportimin e tyre;

- nën tokë ose nën ujë;

- në punët me të sëmurët psikikë e me të meta mendore, në shërbimin e anatomisë patologjike e mjekësisë ligjore, në repartet e sëmundjeve onkologjike.

4. Në shkallën e katërt të dëshmërisë për shëndetin përfshihen punët që kryhen me benzinë, alfa dhe beta naftiloaminë, klorvinil, punët që kryhen në kushtet e ekspozimit ndaj rrezatimit jonizues, si dhe faktorë të tjerë me veprime analogjike në qoftë se kjo do të njihet nga Instituti i Higjienës dhe Epidemiologjisë.

5. Punët që kryhen në kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin konsiderohen ato që kryhen në ambiente që kapërcejnë kufijtë e lejueshëm të faktorëve të dëmshëm për shëndetin të cilët përcaktohen në dispozita të veçanta ose në norma të detyrueshme higjieno-sanitare.

6. Dhënia e shtesës për punët që kryhen në kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin, mbështetet në rezultatet e studimeve të ambientit që kryhen nga institucionet e autorizuar për këto lloj studimesh.

7. Në rastet kur punonjësit i takojnë të marrë më shumë se një shtesë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, shtesat jepen për çdo rast.

UDHËZIM

Nr.13, datë 26.9.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.994, DATË 12.3.2003 “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AUTOSHKOLLAVE” TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, neneve 119, 120 dhe 121 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 310, 311 dhe 313 të vendimit nr.153, datë 7.4.2000 “Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.994, datë 12.3.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e autoshkollave”, të

ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Pika 7, neni 4, ndryshohet si më poshtë vijon:

“7. Plotësimi i kërkesës për automjetet mësimore për lejedrejtimi të kategorisë “C+E”, sipas pikës 10, neni 313, shkronja “d”, të vendimit nr.153, datë 7.4.2000, të ndryshuar, duhet të realizohet brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.”.

Neni 2

Neni 11 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Personat e interesuar, për të hyrë në provën e kontrollit të njohurive teorike dhe në provën e aftësive të drejtimit e të sjelljes, për pajisje me lejedrejtimi të mjetit, sipas kategorive të parashikuara në Kodin Rrugor, regjistrohen nëpërmjet autoshkollës pranë drejtorive rajonale, pasi të paraqesin respektivisht, dokumentet e përcaktuara në pikën 2, neni 311, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor, si dhe formularët sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja.

Spektori përkatës i DRSHTRR-së plotëson regjistrin model DL 2/T dhe pajis me autorizim për kategorinë e kërkuar, sipas modelit DL/T, me afat kohor një vit, personat e interesuar për të hyrë në provën e njohurive teorike për lejedrejtimi mjeti.

Spektori përkatës i DRSHTRR-së plotëson regjistrin model DL 2/P dhe pajis me autorizim për ushtrimin e drejtimit të mjetit, për kategorinë e kërkuar, sipas modelit DL / P, me afat kohor një vit, personat e interesuar që kanë fituar provën e kontrollit të njohurive teorike për lejedrejtimi mjeti.

Modeli i regjistrin DL 2/T dhe DL 2/P, i autorizimit DL/T dhe DL/P, hartohen nga DPSHTRR-ja dhe janë pjesë e këtij udhëzimi.”.

Neni 3

Neni 12 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Të gjithë personat e interesuar, që nuk janë shtetas shqiptarë, mund të pajisen me lejedrejtimi të mjetit, pasi të paraqesin respektivisht, dokumentet e përcaktuara në pikën 2, neni 311, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor, si dhe formularët sipas modelit të hartuar nga DPSHTRR-ja. Vërtetimi i vendbanimit do të zëvendësohet me fotokopje të lejes së qëndrimit, të legalizuar.

Rregullat e përgatitjes dhe të provave, për të marrë lejedrejtimi mjeti, për këta persona të interesuar që nuk janë shtetas shqiptarë, janë të njëjta si për shtetasit shqiptarë.

Në provën e kontrollit të njohurive teorike dhe në provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes, për pajisje me lejedrejtimi mjeti, personi i interesuar që nuk është shtetas shqiptar, mund të marrë dhe përkthyes.”.

Neni 4

Neni 13 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Orët dhe koha e nevojshme, për përgatitjen e njohurive teorike për lejedrejtimi mjeti, në autoshkolla, janë si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------------|----------------------------------|
| 1. Për lejedrejtimi të kategorisë A | 36 orë, në jo më pak se 14 ditë; |
| 2. Për lejedrejtimi të kategorisë B | 54 orë, në jo më pak se 20 ditë; |
| 3. Për lejedrejtimi të kategorisë C | 30 orë, në jo më pak se 12 ditë; |
| 4. Për lejedrejtimi të kategorisë D | 30 orë, në jo më pak se 12 ditë; |
| 5. Për lejedrejtimi të kategorisë BE | 12 orë, në jo më pak se 5 ditë; |
| 6. Për lejedrejtimi të kategorisë CE | 16 orë, në jo më pak se 6 ditë; |
| 7. Për lejedrejtimi të kategorisë DE | 16 orë, në jo më pak se 6 ditë. |

Kur personi i interesuar disponon lejedrejtimi të kategorisë A dhe aplikon për lejedrejtimi të kategorisë B, do t'i nënshtrohet përgatitjes së njohurive teorike prej 18 orësh, në jo më pak se 7 ditë (diferencën e orëve), të përcaktuara në tabelën “Programi mësimor dhe orari”.

Kur personi i interesuar disponon lejedrejtimi të kategorisë B dhe aplikon për lejedrejtimi të kategorisë A, nuk do t'i nënshtrohet përgatitjes dhe marrjes në prova të njohurive teorike për

lejedrejtimi të kategorisë B.

Orët e programuara për njohuritë teorike për lejedrejtimi, do të jenë sipas programit, lidhja A.

Orët dhe koha e nevojshme, për përgatitjen e aftësive drejtuese dhe të sjelljes për lejedrejtimi mjeti, në autoshkolla, janë si më poshtë:

1. Për lejedrejtimi të kategorisë A	12 orë, në jo më pak se 10 ditë;
2. Për lejedrejtimi të kategorisë B	36 orë, në jo më pak se 30 ditë;
3. Për lejedrejtimi të kategorisë C	18 orë, në jo më pak se 15 ditë;
4. Për lejedrejtimi të kategorisë D	18 orë, në jo më pak se 15 ditë;
5. Për lejedrejtimi të kategorisë BE	8 orë, në jo më pak se 6 ditë;
6. Për lejedrejtimi të kategorisë CE	12 orë, në jo më pak se 10 ditë;
7. Për lejedrejtimi të kategorisë DE	12 orë, në jo më pak se 10 ditë.

Orët e programuara për përgatitjen e aftësive drejtuese dhe të sjelljes për lejedrejtimi mjeti, do të jenë në përputhje me nenin 313, pika 13 dhe 15, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor dhe të programit, lidhja A.

Koha e përgatitjes teorike dhe aftësimit të drejtimit dhe të sjelljes, janë në ditë kalendarike.”.

Neni 5

Paragrafi i fundit, neni 14, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në këto raste plotësimi i autorizimit model DL / T dhe DL / P, nga autoshkolla, do të bëhet për kryerjen e plotë të programit.”.

Neni 6

Neni 15 ndryshohet si më poshtë vijon:

“Pas përfundimit të plotë të programit të njohurive teorike ose të programit të aftësive drejtuese dhe të sjelljes, për lejedrejtimi mjeti, autoshkolla paraqet në sektorin përkatës të DRSHTRR-së, dokumentet e përcaktuara për marrjen në provë të personave të interesuar.

Sektori përkatës i DRSHTRR-së, pas paraqitjes së dokumenteve për marrjen në provë të personave të interesuar, në bashkëpunim me autoshkollën, organizon marrjen në prova, sipas afateve kohore të përcaktuara në pikën 8, neni 313, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor.”.

Neni 7

Neni 16 ndryshohet si më poshtë vijon:

“DPSHTRR-ja përcakton anëtarët e komisioneve të marrjes në prova për lejedrejtimi mjeti. Anëtarët e komisioneve duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikat 5 dhe 6, neni 311, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor.

Komisionet e kontrollit të njohurive teorike për lejedrejtimi mjeti e realizojnë provën nëpërmjet testimit, për personat e interesuar. Koha e testimit nuk duhet të jetë më shumë se 45 min.

Personat e interesuar fitojnë provën e kontrollit të njohurive teorike për lejedrejtimi mjeti, kur përgjigjen në mënyrë korrekte 30 pyetjeve ose më shumë, nga 40 pyetje që përmban testi. Testet hartohen nga DPSHTRR-ja, në përputhje me nenin 311, pika 7, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor.

Personat e interesuar fitojnë provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes për lejedrejtimi mjeti, kur kryejnë me saktësi të gjitha kërkesat e përcaktuara në autorizimin model DL/P.

Koha e provës së verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes, për lejedrejtimi mjeti, nuk duhet të jetë më pak se 25 minuta, për kategoritë A, B dhe B+E, dhe jo më pak se 45 minuta, për kategoritë C, C+E, D, D+E.

Personat e interesuar, për provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes, merren në prova me mjetin që janë regjistruar për t’u përgatitur.”.

Neni 8

Neni 17 ndryshohet si më poshtë vijon:

Personat e interesuar për lejedrejtimi mjeti të pajisur me autorizim, DL / T ose DL / P, nuk mund të merren në provë përkatëse nga komisioni, pa realizuar programin e plotë të njohurive teorike ose programin e plotë të aftësive drejtuese e të sjelljes.

Personat e interesuar për lejedrejtimi mjeti kanë të drejtë të paraqiten në provë deri në 5 (pesë) herë, brenda afatit të vlefshmërisë së autorizimit model DL / T ose DL / P.

Personat e interesuar për lejedrejtimi mjeti mund të rifuten në provë, mbas 15 ditëve nga dita e provës që nuk kanë fituar.

Kur personi i interesuar për lejedrejtimi mjeti, nuk fiton provën e verifikimit të aftësive drejtuese e të sjelljes, për një periudhë dyvjeçare, duhet të rifutet në provën e kontrollit të njohurive teorike.”.

Neni 10

Në nenin 19, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1, shprehja “model IV-7” zëvendësohet me “model DL / T ose model DL / P”.
2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Evidenton çdo ditë kandidatët që paraqiten për t’u marrë në provim, në regjistrin e protokollit, “model DL 3 /T ose model DL3 / P”, të hartuar nga DPSHTRR-ja, dhe janë pjesë e këtij udhëzimi.”.

Neni 11

Në nenin 23, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 shfuqizohet.
2. Pika 3 ndyshon si më poshtë vijon:

“3. Merren në provim nga një komision i përbërë nga tre specialistë të DPSHTRR-së, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 6, neni 311, të rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor.”.

Neni 12

Paragrafi i fundit, neni 26, bëhen si më poshtë vijon:

“Në përfundim të seminareve, të gjithë pjesëmarrësit testohen për njohuritë e fituara. Pjesëmarrësit që arrijnë rezultat pozitiv në testim, pajisen me certifikatë. Kjo certifikatë është e vlefshme dhe si dëshmi aftësie për njohuritë teorike në autoshkolla.”.

Neni 13

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi



Modeli DL / T

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Puneve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

AUTORIZIM

PËR PROVËN E KONTROLLIT TË NJOHURIVE TEORIKE,
PËR PAJISJEN ME LEJEDREJTIMI TË MOTOMJETEVE DHE AUTOMJETEVE
(Ligji nr.8378, datë 22.7.1998, neni 119, VKM nr.153 datë 7.4.2000, neni 311)

KËRKUESI:

EMRI _____ MBIEMRI _____ ATËSIA _____

AMËSIA _____ DATËLINDJA ____/____/____ VENDLINDJA _____

VENDBANIMI _____ ADRESA _____

DOKUMENT IDENTIFIKUES _____ NR. _____

KATEGORIA E LEJEDREJTIMIT QË KA “ _____ ” Nr.prot. ____/____/____ datë ____/____/____

KATEGORIA E LEJEDREJTIMIT PËR TË CILËN KERKON TË AFTËSOHET “ _____ ”
(_____)

Emër, mbiemër, firmë)

AUTOSHKOLLA “ _____ NR.LICENCËS _____ DATË ____/____/____

PERIUDHA E PËRGATITJES NGA DATA ____/____/____ (_____)

(me shkrim)

DERI MË DATË ____/____/____ (_____).

(me shkrim)

DREJTUESI TEKNIK I AUTOSHKOLLËS (_____)

Emër, mbiemër, firmë, vulë

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR _____

Nr. _____ prot. Datë ____/____/____

NËPUNËSI I NGARKUAR

(_____)

Emër, mbiemër, firmë

Udhëzues: 1. Ky është dokument publik dhe i jepet kërkuesit të tij për t’u paraqitur në testim brenda juridiksionit të drejtorisë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor që e lëshon.

2. Ndryshimi, korrigjimi ose falsifikimi i tij dënohet me ligj dhe e bën të pavlefshëm autorizimin. Në rast ndryshimi ky duhet të zëvendësohet me autorizim të ri nga drejtoria rajonale që e ka lëshuar.

PËRFUNDIMI I PROGRAMIT TË NJOHURIVE TEORIKE TË DREJTIMIT TË MJETIT

Kandidati _____ i regjistruar me nr. regjistri themeltar (amzë) _____

(me shifër dhe shkrim) plotësoi orët e zhvilluara nga programi i njohurive teorike

gjithsej _____ (me shifra dhe shkrim), dhe deklaroi se është i aftë t’i nënshtrohet provës së njohurive teorike.

DREJTUESI TEKNIK I AUTOSHKOLLËS
(
Emër, mbiemër, firmë, vulë

Data ()
(me shifër dhe shkrim)

VLERËSIMI I KOMISIONIT TË PROVËS SË NJOHURIVE TEORIKE

Numri i provave	Nr. protokollit e data e marrjes në prova	Nr. testit	Rezultati i provës përgjigje të sakta (me shifër e shkrim)	Rezultati (me shkrim) fiton/nuk fiton	Komisioni vlerësues (emër, mbiemër, firmë)
I					Kryetar:
					Anëtar:
II					Kryetar:
					Anëtar:
III					Kryetar:
					Anëtar:
IV					Kryetar:
					Anëtar:
V					Kryetar:
					Anëtar:

Kandidati () fiton "Provën e njohurive teorike" për leje drejtimi të kategorisë " " me vendimin komisionit nr/prot. datë

KOMISIONI

ANËTARI
(
Emër, mbiemër, firmë

KRYETARI
(
Emër, mbiemër, firmë

REGJISTRI I KANDIDATËVE PER DREJTUES MJETI (TEORI)

[illegible]

REGJISTËR PROTOKOLLI PËR MARRJEN NË PROVA TEORIKE NR.

DATË / /

[illegible]



Modeli DL / P

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT RRUGOR

AUTORIZIM

PËR USHTRIMIN E DREJTIMIT TË MOTOMJETEVE DHE AUTOMJETEVE E TË PROVËS PËR
VERIFIKIMIN E AFTËSIVE DREJTUESE DHE TË SJELLJES, PËR PAJISJEN ME LEJEDREJTIMI
(Ligji nr.8378, datë 22.7.1998, neni 120)

KËRKUESI:

EMRI _____ MBIEMRI _____ ATËSIA _____

AMËSIA _____ DATËLINDJA ____/____/____ VENDLINDJA _____

VENDBANIMI _____ ADRESA _____

DOKUMENTI IDENTIFIKUES _____ NR. _____

KATEGORIA E LEJEDREJTIMIT QË KA “ _____ ” Nr.prot. ____/____/____ datë ____/____/____

KATEGORIA E LEJEDREJTIMIT PËR TË CILËN KËRKON TË AFTËSOHET ” _____ ”
(_____)

Emër,mbiemër,firmë)

KA FITUAR PROVAT E NJOHURIVE TEORIKE PËR LEJE DREJTIMI TË KATEG. ____ nr. ____ prot. ____ Datë ____

AUTOSHKOLLA “ _____ ” NR.LICENCËS _____ DATË ____/____/____

PERIUDHA E PËRGATITJES NGA DATA ____/____/____ (_____)
(me shkrim)

DERI MË DATË ____/____/____ (_____).
(me shkrim)

DREJTUESI TEKNIK I AUTOSHKOLLËS

(_____)

Emër, mbiemër, firmë, vulë

DREJTORIA RAJONALE E SHËRBIMEVE TË TRANSPORTIT
RRUGOR

Nr. _____ Prot. _____ Datë ____/____/____

NËPUNËSI I NGARKUAR

(_____)

Emër, mbiemër, firmë

- Udhëzues:**
1. Ky është dokument publik dhe i jepet kërkuarit të tij për t'u ushtruar në stërvitjen praktike e për t'u paraqitur në testim brenda juridiksionit të drejtorisë rajonale të shërbimeve të transportit rrugor që e lëshon.
 2. Ndryshimi, korrigjimi ose falsifikimi i tij dënohet me ligj dhe e bën të pavlefshëm autorizimin. Në rast ndryshimi ky duhet të zëvendësohet me autorizim të ri nga drejtoria rajonale që e ka lëshuar.
 3. Pavarësisht nga rubrikat e shënuara te “Veprimet praktike që do të testohen”, marrja në prova praktike e kandidatit për kategorinë e lejes së drejtimit të kërkuar, duhet të bëhet në përputhje me programin e hartuar në rregulloren për këtë qëllim.

PËRFUNDIMI I PROGRAMIT TË USHTRIMIT TË DREJTIMIT TË MJETIT

Kandidati _____ i regjistruar me nr.regjistri themeltar (amzë) _____ (me shifër dhe shkrim) plotësoi orë të zhvilluara në mësimin praktik gjithsej _____ (me shifra dhe shkrim), dhe deklaron se është i aftë t'i nënshtrohet provimit praktik.

DREJTUESI TEKNIK I AUTOSHKOLLËS

(_____)

Data

(_____)

Emër, mbiemër, firmë

Vula (me shifër dhe shkrim)

VLERËSIMI I KOMISIONIT TË PROVËS SË AFTËSIVE DREJTUESE DHE TË SJELLJES

Nr	Veprime praktike që do të testohen	PROVA I DT. _____	PROVA II DT. _____	PROVA III DT. _____	PROVA IV DT. _____	PROVA V DT. _____
I	Përgatitje dhe kontroll i mjetit me qëllim sigurinë rrugore					
1	Rregullim i sediljes, pasqyrave, të rripave të sigurimit dhe mbështetës së mundshme të kokës					
2	Kontroll i kushteve të rrotave dhe bulonave, dritareve, pastruesve të xhamave dhe të niveleve (vaj motori, lëng ftohës, lëng për të larë xhamat etj.)					
4	Kontrolli i presionit të ajrit, i depozitës së ajrit, kompresorit dhe të jastëkëve të ajrit					
5	Kontroll i freksionit dhe frenave, por edhe lidhjeve elektrike për kategori të veçanta					
II	Manovrimë të veçanta objekt i provave me qëllim sigurinë në rrugë					
1	Lidhje dhe zgjidhje e rimorkios ose gjysmërimorkios nga makina që e tërheq					
2	Marsh indietro në linjë të drejtë ose me kthim djathtas ose majtas duke iu përmbajtur korsisë së saktë					
3	Frenim i saktë duke respektuar pikën e ndalimit të parapërcaktuar; ekzekutimi i një frenimi emergjence është i kërkuar					
4	Parkim i makinës dhe dalje nga hapësira e parkingut (paralel, drejt ose jodrejt, marsh përpara ose mbrapa; në rafsh ose në pjerrësi)					
5	Kthim i makinës, duke iu drejtuar si marshit përpara ashtu edhe marshit indietro					
6	Parkim në siguresë për veprime të ngarkim/shkarkimit ose ngjitjen/zbritjen e pasagjerëve					
III	Sjellja në trafik					
1	Nisja nga frenimi: nga një parking, pas një qëndrimi në trafik; duke dalë nga një rrugë sekondare					
2	Drejtimi i mjetit në rrugë të drejtë; sjellja në përballje me mjetet e tjera që vijnë në drejtim të kundërt					
3	Drejtimi i mjetit në kthesë dhe në rast të një hapësire të kufizuar					
4	Zgjedhja e korsisë së duhur përpara kryqëzimit					
5	Veprimet në kryqëzime me dhe pa semafor, me drejtues trafiku, përballim dhe kalim i kryqëzimeve dhe rrugëve të ndërlidhëse					
6	Ndryshim drejtimi: kthim djathtas ose majtas; ndryshim korsie					
7	Hyrje/dalje nga autostrada (ose të rrugë të mundshme të njëjta me të); hyrje përmes korsisë së shpejtësisë; dalje përmes korsisë së ngadalësimit					
8	Parakalimi i mjeteve të tjera, kalimi i pengesave (për shembull mjete të parkuara); të qëniet objekt i parakalimit nga ana e mjeteve të tjera					
9	Prova në rrethrotullime, kalime në nivel, ndalesa të autobusëve, përmeskalime të këmbësorëve					
10	Drejtimi i mjetit në ngjitje/zbritje të gjata, ndalimi dhe nisja nga vendi në rrugët në ngjitje					
11	Përdorimi i duhur i marsheve dhe freksionit sipas kushteve të rrugës					
12	Zotërimi i timonit, mbajtja e krahut të duhur në qarkullim					
13	Respektimi i sinjaleve vertikale dhe horizontale					
14	Masat për daljen e sigurt nga mjeti					
REZULTATI I PROVËS (Fiton / Nuk fiton)						

Kandidati (_____) fiton "Provën e aftësive drejtuese dhe të sjelljes" për leje drejtimi të kategorisë " _____ "me vendimin e komisionit Nr/prot. _____ datë _____

KOMISIONI

ANËTARI

(_____)

Emër, mbiemër, firmë

KRYETARI

(_____)

Emër, mbiemër, firmë

REGJISTRI I KANDIDATËVE PËR DREJTUES MJETI (PRAKTIKË)

Nr.	Datë	Emër, atësi, mbiemër	Datëlindja	Vendlindja	Vendbanimi	Seksi	Teoria			Praktika				
						M/F	Nr. prot	Data	Kateg.	Emri Autoshkolla	Mjeti targa	Instruktori	Data e fillimit	Data e mbarimi
1														
2														
3														
4														
5														
6														
7														
8														
9														
10														
11														
12														
13														
14														
15														
16														
17														
18														
19														
20														
21														
22														
23														
24														
25														
26														
27														
28														
29														
30														

REGJISTËR PROTOKOLLI PËR MARRJEN NË PROVA PRAKTIKE NR.

DATË / /

Nr.	Emër, mbiemër	Atësia	Amësia	Datëlindja	Vendlindja	Vendbanimi (Adresa)	Teoria			Autoshkolla		Nr. i provimit	Rezultati i praktikës	Rezultati përfundimtar (me shkrim + kategoria)
							N. prot.	Data	Kateg.	Nr.amzës	Emri			
1														
2														
3														
4														
5														
6														
7														
8														
9														
10														
11														
12														
13														
14														
15														
16														
17														
18														
19														
20														
21														
22														
23														
24														
25														
26														
27														
28														
29														
30														

VENDIM
Nr.20, datë 29.9.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 3.7.2008, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.12 Akti që i përket:

KËRKUES: Qamil Spahija, përfaqësuar nga av.Bujar Hoti, me prokurë.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Naim Haxhagiq, përfaqësuar nga av.Shyqyri Dylgieri, me deklaram.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr.20, datë 7.4.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Fehmi Abdiu, përfaqësuesin e kërkuarit që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar që kërkoi rrëzimin e kërkesës dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.2266, datë 16.9.1996, duke rrëzuar kërkesëpadinë e kërkuarit Qamil Spahija, (kërkuari) dhe duke pranuar kundërpadinë e të paditurit Naim Haxhagiq (subjekti i interesuar), ka vendosur: i) rrëzimin e kërkesës për pagim qiraje; ii) anulimin e vendimit nr.163, datë 16.3.1994 të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave që përcakton kthim në natyrë kërkuarit të 122 m² truall, mbi të cilin është ndërtuar lokali i subjektit të interesuar; iii) njohjen si pronar truallit të subjektit të interesuar për 122 m²; iv) detyrimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave që të kompensojë kërkuarin për këtë sipërfaqe truall.

Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.6478, datë 21.11.1996. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.1291, datë 5.11.1997, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.6478, datë 21.11.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Mbi kërkesën e kërkuarit, Kolegji Seleksionues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.Q-14, datë 5.6.2001, ka vendosur mospranimin e rekursit në interes të ligjit si të pabazuar.

Kërkuari, duke kontestuar për falsitet lejen e ndërtimit, ka bërë kallëzim kundër shtetasit (të paditurit) Naim Haxhagiq. Me vendimin nr.250, datë 12.10.2005, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur: i) pushimin e gjykimit të çështjes penale nr.289 akti, datë 24.6.2005, ndaj të pandehurit Naim Maliq Haxhagiq, pasi autori që ka kryer këtë vepër penale ka vdekur; ii) bazuar në nenin 391/1 të Kodit të Procedurës Penale, dokumenti leje ndërtimi me nr.407 prot. datë 9.12.1991, pa shënimin: “shënim dyqani është miratuar të ndërtohet provizor (me material provizor), si dhe “u pa” nënshkrimi dhe 9.12.91” krahasuar me lejen e ndërtimit me nr.407 prot. datë 9.12.1991 vërtetuar nga bashkia Shkodër, më datë 22.4.2005 me shënimin “shënim: dyqani është miratuar të ndërtohet provizor (me

material provizor), si dhe “u pa nënshkrimi dhe 9.12.1991”, të asgjësohet.

Sipas këtij vendimi, i cili ka marrë formë të prerë, është vërtetuar se vepra penale e falsifikimit të dokumenteve zyrtare është kryer nga babai i subjektit të interesuar, i cili në kohën e këtij procesi gjyqësor penal rezultonte i vdekur.

Më datë 21.11.2005, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimit nr.2266, datë 16.9.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, vendimit nr.6478, datë 21.11.1996 të Gjykatës së Apelit Tiranë, vendimit nr.1291, datë 5.11.1997 të Gjykatës së Lartë, vendimit nr.Q-14, datë 5.6.2001 të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë. Kërkuesi ka paraqitur si shkak rishikimi faktin se me vendim penal të formës së prerë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është vendosur të asgjësohet dokumenti i lejes së ndërtimit si dokument i falsifikuar, i përdorur si provë nga subjekti i interesuar në procesin civil pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Gjykata e Lartë (Dhoma e Këshillimit), me vendimin e saj nr.20, datë 7.4.2006, ka vendosur “Mospranimin e kërkesës së kërkuesit për rishikimin e vendimit nr.2266, datë 16.9.1996 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër”, duke e konsideruar si kërkesë të paraqitur jashtë afatit prekluziv 1-vjeçar të parashikuar nga neni 445 i Kodit të Procedurës Civile.

Kërkuesi ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr.20, datë 7.4.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (vendimi), duke parashtruar këto shkaqe:

- Kolegji Civil (Dhoma e Këshillimit) ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile, duke i mohuar të drejtën e aksesit.

- Kolegji ka vendosur në kundërshtim me vendimin nr.8, datë 24.3.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me interpretimin e afatit të paraqitjes së kërkesës për rishikim.

- Gjykata ka shkelur të drejtën për një proces të rregullt ligjor, sepse nuk ka shqyrtuar në seancë gjyqësore pretendimet e ngritura në kërkesën për rishikim.

Subjekti i interesuar ka pretenduar si shkak për rrëzimin e kërkesës së kërkuesit se:

- Gjykata ka cenuar një të drejtë të fituar ligjërisht më përpara.

- Gjykata ka vepruar në kundërshtim me parimin e gjësë së gjykuar, pasi për të njëjtin shkak, me kërkuesin është përfshirë në një konflikt gjyqësor të stërzgatur dhe që aktualisht ndodhet në gjykim në Gjykatën e Lartë.

- Çështja objekt shqyrtimi, nga pikëpamja procedurale, është shqyrtuar më përpara dhe në Gjykatën Kushtetuese.

II

Kërkuesi ka pretenduar se vendimi i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor, çka vjen në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (Kushtetuta) dhe me nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ). Ai ka kërkuar shfuqizimin e këtij vendimi, sepse i është mohuar e drejta për t’iu drejtuar gjykatës dhe si rrjedhojë, e drejta e pronësisë mbi truallin.

Në shqyrtimin e kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e kërkuesit duhet të vlerësohen të veçuara në kuadër të standardeve dhe elementeve përbërëse të procesit të rregullt ligjor, në kuptim të neneve 42 e 131/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të nenit 6 të KEDNJ.

1. Pretendimi i kërkuesit se Gjykata e Lartë (Dhoma e Këshillimit) duke shkelur nenin 445 të Kodit të Procedurës Civile dhe duke mos zbatuar vendimin nr.8, datë 24.3.2005 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me interpretimin e afatit të paraqitjes së kërkesës për rishikim, i ka mohuar të drejtën për t’u paraqitur para gjykatës, dhe si rrjedhojë dhe të drejtën e pronësisë.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në çështjen në shqyrtim, i është referuar vetëm nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile dhe ka arritur në përfundimin se kërkuesi e ka paraqitur kërkesën për rishikim tej afatit njëvjeçar nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë.

Në çështjen në shqyrtim, çmohet e nevojshme për të qëndruar në disa momente që kanë të bëjnë me interpretimin e ligjit procedural, që është atribut i gjykatave të sistemit gjyqësor dhe i organeve që e zbatojnë atë. Duke u nisur nga ky parim, del se dhe sqarimi i kuptimit të çdo dispozite të Kodit të Procedurës Civile dhe raporti i saj me dispozitat e tjera të përafërta me të për zbatimin e tyre në gjykimet e çështjeve është në kompetencë të gjykatave të sistemit gjyqësor (*shih vendimin nr.19,*

datë 23.12.2004 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata ka vlerësuar se problemet e interpretimit dhe zbatimit të ligjit mund të merren në konsideratë prej saj vetëm nëse përmes këtij procesi cenohen të drejta kushtetuese themelore (*shih vendimin nr.4, datë 28.2.2006 të Gjykatës Kushtetuese*).

Në çështjen në gjykim kjo Gjykatë çmon se është e domosdoshme të ballafaqojë përmbytjen e nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile e ato të dispozitave të kapitullit të tretë që trajtojnë institutin e rishikimit (nenet 494-498), veçanërisht me përmbytjen e nenit 496 të këtij Kodi. Këto dy dispozita dallojnë nga njëra-tjetra sepse: i) neni 445 sanksionon prekluzivitetin (afatin) e ankimit si mjet procedural për të gjitha llojet e ankimit, përfshirë dhe kërkesën për rishikim, duke pasur parasysh se zë vend në titullin e parë të pjesës së tretë të Kodit, kurse neni 496 sanksionon afatin ligjor vetëm përsa i përket kërkesës për rishikim që zë vend në titullin e tretë të pjesës së tretë të Kodit; ii) neni 445 përcakton vetëm ankimin njëvjeçar nga shpallja e vendimit, kurse neni 496 përcakton afatin njëvjeçar që nga dita që ka lindur shkakun e rishikimit; iii) neni 445 nuk ka si qëllim përcaktimin e afatit për ankim, ndërsa neni 496 saktëson afatin 30-ditor si determinat nga dita që pala ka marrë dijeni për shkakun e rishikimit.

Nga sa më lart, në rastet e paraqitjes së kërkesës për rishikimin e një vendimi të formës së prerë, neni 445 i Kodit të Procedurës Civile duhet të zbatohet në harmoni me nenin 496 të këtij Kodi, përsa i përket afatit prekluziv njëvjeçar. Pra, ky afat llogaritet ose nga momenti që është shpallur vendimi që ankimohet ose nga momenti që merr formë të prerë vendimi që përmban shkakun e rishikimit të parashikuar nga neni 494 i Kodit të Procedurës Civile. Nëse nuk do të interpretohej në këtë mënyrë, neni 445 i Kodit të Procedurës Civile, ashtu si është shkruar do të ishte i paaplikueshëm, duke ia ngushtuar hapësirat individit për të pasur akses në gjykatë dhe për të shfrytëzuar mjetin procedural të jashtëzakonshëm të kërkesës për rishikim.

Nisur nga ky interpretim, Gjykata vlerëson se për çështjen në shqyrtim, afati i kërkesës për rishikim të kërkuarit duhet të fillojë nga marrja formë të prerë e vendimit që përmban shkakun e rishikimit. Meqenëse vendimi që ka vërtetuar rrethanën e falsifikimit ka marrë formë të prerë me datë 14.11.2005 dhe kërkuari e ka paraqitur kërkesën për rishikim pranë Gjykatës së Lartë me datë 21.11.2005, kërkesa duhet të konsiderohet se është paraqitur brenda afatit njëvjeçar. Këtë qëndrim kanë mbajtur dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë me vendimin nr.8, datë 24.3.2005 duke arsyetuar se: “Ligjvënësi e ka klasifikuar kërkesën për rishikim në mjetet për t’u ankuar ndaj vendimeve të gjykatave, krahas apelit dhe rekursit (neni 442 i Kodit të Procedurës Civile). Ky afat prekluziv (dekadencë) llogaritet nga momenti që është shpallur vendimi që ankimohet apo vendimi i formës së prerë që përmban shkakun e rishikimit, sipas rasteve të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile. Si përfundim, në rastet e paraqitjes së kërkesës për rishikimin e një vendimi të formës së prerë, neni 445 i Kodit të Procedurës Civile duhet të zbatohet në harmoni me nenin 496 të këtij Kodi, përsa i përket afatit prekluziv njëvjeçar, për pasojë, paraqitja e kërkesës tej këtij afati e bën atë të papranueshëm”.

Gjykata Kushtetuese konstaton se interpretimi jo i drejtë i dispozitave në fjalë ka lidhje të drejtpërdrejtë me standardet kushtetuese që lidhen me procesin e rregullt ligjor, dhe i ka mohuar kërkuarit të drejtën e aksesit për t’iu drejtuar gjykatës dhe për të kërkuar të drejtën e pronësisë.

Për sa më sipër, Gjykata e gjen të mbështetur pretendimin për cenim të procesit të rregullt ligjor për shkak të interpretimit të gabuar të nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile lidhur me afatin e paraqitjes së kërkesës për rishikim. Ky vlerësim i gjykatës ka të bëjë me cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi duke mos u zbatuar dispozitat procedurale të Kodit të Procedurës Civile, si dhe standardet e nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ, kërkuarit i është mohuar e drejta kushtetuese e aksesit dhe rrjedhimisht, pretendimi për të drejtën e pronësisë.

2. Pretendimi i kërkuarit se nuk janë shqyrtuar në seancë gjyqësore pretendimet e ngritura në kërkesën për rishikim.

Kërkuari pretendon shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, sepse nuk janë shqyrtuar në seancë gjyqësore pretendimet e ngritura në kërkesën për rishikim.

Ky pretendim i kërkuarit nuk qëndron, sepse në paragrafin e parë të nenit 498 të ndryshuar, thuhet se: “... kur kërkesa është bërë jashtë rasteve të përcaktuara në nenin 494 ose kur është bërë nga ata që nuk e kanë këtë të drejtë, si dhe kur rezulton haptazi e pambështetur, gjykata vendos mospranimin e saj”. Nga ky përcaktim ligjor kuptohet, se shqyrtimi i kërkesës nga Gjykata e Lartë, kur ajo është bërë jashtë kriterëve ligjorë, bëhet në Dhomën e Këshillimit pa pjesëmarrjen e palëve. Një verifikim i tillë i kërkesës, nëse i plotëson ose jo kushtet për shqyrtim, është atribut i Dhomës së

Këshillimit dhe jo i seancës gjyqësore. Aq më tepër, që mospranimi i kërkesës vendoset pas këtij shqyrtimi paraprak dhe jo në seancë gjyqësore. Prandaj, përcaktimi në ligj, se në këto raste gjykata vendos mospranimin, dëshmon se shqyrtimi i kërkesës për rishikim për të verifikuar paraqitjen e saj sipas kriterëve ligjore, bëhet në Dhomën e Këshillimit. Ky është qëndrimi i ligjvënësit, i përcaktuar edhe në nenin 480 të Kodit të Procedurës Civile për shqyrtimin e rekursit në dhomën e këshillimit” (shih vendimin nr.6, datë 26.2 2003, të gjykatës kushtetuese).

Për sa më sipër, Gjykata nuk e gjen të mbështetur pretendimin për cenim të procesit të rregullt ligjor, për shkak se nuk janë shqyrtuar në seancë gjyqësore pretendimet e ngritura nga kërkuesi në kërkesën për rishikim.

3. Pretendimi i subjektit të interesuar se është cenuar në një të drejtë të fituar ligjërisht më përpara, duke qenë se ka një vendim gjyqësor të formës së prerë në favor të tij.

Jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese konceptin e sigurisë juridike, të të drejtës së fituar, të pritshmërisë së ligjshme dhe të besimit të qytetarëve të shteti i referon te parimi i shtetit të së drejtës” (shih vendimin nr.9, datë 26.2.2007 të Gjykatës Kushtetuese).

Për sa i përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata ka një jurisprudentë të sajën, duke u shprehur se: “Çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të “procesit të rregullt” përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku kërkohet të cenohen të drejtat e fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre” (shih vendimin nr.8, datë 2.5. 2006 të Gjykatës Kushtetuese).

Po kështu kjo Gjykatë ka pohuar se: “...shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykata vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga një palë pa dëgjuar pretendimet e komentet e palës tjetër, është shoqëruar në çështjen në shqyrtim me prishjen e vendimit të formës së prerë, pra me cenimin e gjendjes juridike të krijuar dhe të të drejtës së fituar më parë. Këto të drejta nuk mund të cenohen pa u respektuar të drejtat kushtetuese të palëve në gjykim” (shih vendimin nr.5, datë 26.1.2007 të Gjykatës Kushtetuese).

Në çështjen në shqyrtim, subjekti i interesuar ka fituar të drejtën e pronës me vendim gjyqësor të formës së prerë, por legjislacioni shqiptar, dhe konkretisht Kodi i Procedurës Civile në dispozitat 445 e në vijim, ka parashikuar mënyra ankimi ndaj vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nëpërmjet një mjeti procedural të jashtëzakonshëm, sikundër është kërkesa për rishikim. Në kontekstin e çështjes në shqyrtim, pritshmëria e ligjshme e kërkuetit ka qenë pranimi i kërkesës së tij për rishikim, nisur nga fakti se Gjykata e Lartë ka pasur një vendim unifikues mbi këtë çështje, ku ka shprehur qëndrimin e saj ndaj dispozitave ligjore, që nënkupton një përqasje dhe pritshmëri të ligjshme për pranimin e kërkesës për rishikim. Për sa kohë që kërkueti kishte në dorë një mjet ankimi për të ezauruar, edhe pse i jashtëzakonshëm, ai ishte në kushtet ku mund të fitonte të drejtën e tij (pritshmëri e ligjshme).

Subjekti i interesuar, ndër të tjera, pretendoi se në kundërshtim me parimin e gjësë së gjykuar, për të njëjtin shkak, ai me kërkuetin janë të përfshirë në një konflikt gjyqësor të stërzgatur që ndodhet aktualisht në gjykim në Gjykatën e Lartë.

Gjykata konstatoi se konflikti për të cilin subjekti i interesuar pretendon se ndodhet në proces gjykimi në Gjykatën e Lartë është me të njëjtat palë, por me objekt të ndryshëm. Rekursi i paraqitur pranë kësaj gjykate nga z.Naim Haxhagiq dhe bashkia Shkodër ka si objekt shfuqizimin e vendimit nr.2239, datë 20.10.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me anë të të cilit është vendosur fshirja nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e pronës në favor të z.Naim Haxhagiq dhe konstatimi i pavlefshmërisë absolute të kontratës së shitjes së truallit, si dhe shfuqizimin e vendimit nr.118, datë 26.3.2007 të Gjykatës së Apelit Shkodër që ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër nr.2239, datë 20.10.2006.

Edhe pretendimi tjetër se nga pikëpamja procedurale konflikti është shqyrtuar në të gjitha shkallët e gjykimit, duke përfshirë dhe Gjykatën Kushtetuese nuk qëndron, sepse kjo gjykatë, me vendimin nr.37, datë 16.9.1998, ka vendosur moskalimin për shqyrtim të çështjes me objekt: shfuqizimin si të papajtuësishëm me Kushtetutën të vendimit nr.1291, datë 5.11.1997 të Kolegjit Civil të Kasacionit. Ndërkohë, që me kërkesën në shqyrtim kërkueti kërkon shfuqizimin e vendimit nr.20, datë 7.4.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).

Sa më lart, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga kërkueti është e bazuar në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së dhe për rrjedhojë, duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f të Kushtetutës dhe nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës së kërkuarit Qamil Spahija, deklarimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr.20, datë 7.4.2006 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (Dhoma e Këshillimit).

- Dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, (Dhoma e Këshillimit).

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Vladimir Kristo (kryetar)

Anëtarë pro: Xhezair Zaganjori, Sokol Sadushi, Vitore Tusha, Petrit Ploçi, Fehmi Abdiu, Sokol Berberi.

Anëtar kundër: Gjergj Sauli.

VENDIM

Nr.21, datë 1.10.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese,
Gjergj Sauli	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Ploçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Brunilda Bara, sot më datë 5.2.2008, mori në shqyrtim çështjen me nr.1 Akti, që i përket:

KËRKUES: Theodhori Sollaku, përfaqësuar nga avokatët Fatmir Braka e Arjan Salati, me deklaram.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

KUVENDI I SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga Lulzim Leçaj, me autorizim.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, i përfaqësuar nga Artur Metani, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i dekretit nr.5523, datë 22.11.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë dhe i vendimit nr.141, datë 5.11.2007 të Kuvendit të Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuarit që u shprehën për pranimin e kërkesës, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara që u shprehën për rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Kërkuesi Theodhori Sollaku ka kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.141, datë 5.11.2007 të Kuvendit të Shqipërisë, me të cilin është miratuar raporti i Komisionit Hetimor për të propozuar shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe të dekretit të Presidentit të Republikës nr.5523, datë 22.11.2007, me të cilin është shkarkuar nga detyra e Prokurorit të Përgjithshëm.

Nga gjykimi i çështjes rezultoi se Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr.135, datë 25.10.2007 ka ngritur një komision hetimor për verifikimin e pretendimeve të ngritura nga një grup deputetësh për shkelje të rënda të ligjit nga ana e Prokurorit të Përgjithshëm. Vendimi i Kuvendit për ngritjen e komisionit hetimor është marrë pas shqyrtimit paraprak të kërkesës së deputetëve në Komisionin Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ku u dëgjuan edhe deklaratimet e Prokurorit të Përgjithshëm lidhur me bazueshmërinë në ligj e në prova të kërkesës së deputetëve.

Pas verifikimeve të bëra nga Komisioni Hetimor, Kuvendi i Shqipërisë mori në shqyrtim në seancë plenare raportin e këtij Komisioni dhe dëgjoi edhe kërkuesin. Me vendimin nr.141, datë 5.11.2007, Kuvendi vendosi ta miratojë raportin e Komisionit Hetimor me titull “Për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm” dhe t’ia dërgojë atë Presidentit të Republikës.

Presidenti i Republikës verifikoi pretendimet e kërkuesit duke i ballafaquar ato me dokumentet dhe të gjithë praktikën e Komisionit Hetimor e të Kuvendit. Ai dëgjoi edhe mendimin e komisionit të ekspertëve të ngritur prej tij dhe me dekretin nr.5523, datë 22.11.2007, shkarkoi nga detyra Prokurorin e Përgjithshëm me motivacionin “shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksionit të tij”.

Kërkuesi, duke pretenduar se dekreti i Presidentit dhe vendimi i Kuvendit janë rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor, ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin e tyre:

- Kuvendi dhe Presidenti nuk e njohën dhe as e dëgjuan në lidhje me provat/faktet që përligjin shkaqet kushtetuese të shkarkimit.

- Mosrespektimi i procedurave të hetimit dhe, veçanërisht të atyre që lidhen me njoftimet e palëve në procese me të drejtën e mbrojtjes, i bën aktet përfundimtare të hetimit absolutisht të pavlefshme.

- Kuvendi dhe Presidenti i Republikës, gjatë procedurave për shkarkim, shkelën haptazi edhe parimet e tjera të procesit të rregullt ligjor si prezumimi i pafajësisë, mosgjykimi dy herë i së njëjtës çështje, respektimi i ndarjes së pushteteve etj.

Përfaqësuesi i Kuvendit ka parashtruar:

- Kërkuesi mund të legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese pasi t’i jetë drejtuar gjykatave të sistemit gjyqësor.

- Është Presidenti i Republikës organi kompetent për të kryer verifikimin nga pikëpamja kushtetuese, të shkaqeve e procedurave të ndjekura nga Kuvendi për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

- Kuvendi ka respektuar kërkesat e procesit të rregullt ligjor gjatë procedurës për shkarkimin e kërkuesit.

- Prokurori i Përgjithshëm është vënë në dijeni për përmbajtjen e fakteve e dokumenteve, të dërguara edhe më parë në rrugë zyrtare.

Përfaqësuesi i Presidentit ka parashtruar:

- Presidenti i Republikës ka vlerësuar kundërshtimet e Prokurorit të Përgjithshëm për procedurën e ndjekur.

- Presidenti verifikoi pretendimet e kërkuesit dhe arriti në përfundimin se ai duhet shkarkuar nga detyra.

I

1. Kërkuesi pretendoi se ai legjitimohet të vërë në lëvizje si individ Gjykatën Kushtetuese për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit të Kuvendit, që propozon shkarkimin dhe të dekretit të Presidentit që vendos shkarkimin. Kjo sepse është shkelur parimi kushtetues për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe si rrjedhojë i janë cenuar të drejtat

kushtetuese e ligjore. Ai pretendon, gjithashtu se përderisa sipas Kodit të Procedurës Civile nuk mund të shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme aktet me karakter administrativ që dalin nga zbatimi i procedurave parlamentare, duhet konsideruar se në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës ai i ka shteruar mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese e ligjore për një proces të rregullt ligjor.

Lidhur me këtë pretendim, përfaqësuesi i Kuvendit deklaroi në seancë gjyqësore se kërkuesi nuk mund të legjitimohet të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese pa iu drejtuar më parë të gjitha shkallëve të sistemit gjyqësor. Ai deklaroi, gjithashtu, se vendimi i Kuvendit nuk mund të goditet në Gjykatën Kushtetuese sepse nuk është një vendim përfundimtar, por vetëm iniciimi i një procedure shkarkimi. Sipas tij është Presidenti i Republikës organi i ngarkuar nga Kushtetuta për të verifikuar dhe vendosur për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Gjykata Kushtetuese, bazuar edhe në praktikën e saj të mëparshme, arriti në përfundimin se kërkuesi legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën si të vendimit të Kuvendit, ashtu edhe të dekretit të Presidentit për shkarkimin e tij nga detyra.

Neni 131/f i Kushtetutës, në lidhje me nenin 134/1/g të saj, i jep të drejtë individit të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për shkëljen e të drejtave të tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave, d.m.th, pasi individit të jetë drejtuar e të ketë marrë përgjigje nga organet e tjera kompetente shtetërore. Në rastin e kërkesave kundër vendimit të Kuvendit dhe përkatësisht të dekretit të Presidentit për shkarkimin nga detyra, kërkuetit nuk mund të vënë në lëvizje ndonjë organ tjetër shtetëror për shqyrtimin e tyre veç Gjykatës Kushtetuese, sepse asnjë prej organeve të tjera shtetërore nuk ka në kompetencë shqyrtimin e këtyre kërkesave.

Sipas neneve 324 e 333 të Kodit të Procedurës Civile nuk mund të shqyrtohen nga gjykatat e zakonshme aktet me karakter administrativ, të cilat janë rezultat i procedurave parlamentare. Këtë qëndrim mban edhe Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.76, datë 25.4.2002, sipas të cilit dekreti i Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm, si një akt individual me karakter administrativ, nuk mund të trajtohet në të njëjtën mënyrë si aktet e tjera administrative, të cilat shqyrtohen nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Veçantia e këtij dekreti të Presidentit të Republikës qëndron në faktin, se ai është i lidhur pazgjidhmërisht me procedurat parlamentare në bazë të të cilave ka dalë vendimi i Kuvendit që është një premisë e domosdoshme për nxjerrjen e dekretit. Dekreti i kundërshtuar në këtë gjykim është i tillë. Ai është rezultat i procedurave parlamentare në bazë të të cilave është kërkuar shkarkimi i Prokurorit të Përgjithshëm, pasi është miratuar komisioni hetimor dhe është miratuar raporti i këtij komisioni me propozimin për shkarkim që i bëhet Presidentit të Republikës.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin e mësipërm, ka pranuar gjithashtu se cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës sjell cenimin e realizimit të të drejtave të tjera kushtetuese e ligjore. Për këtë arsye, mbrojtja kushtetuese realizohet në rastin e të gjitha konflikteve që janë vendimtare për pozicionin juridik të një personi, qoftë ai edhe funksion publik, duke e parë funksionin e funksionarit publik në këndvështrimin e garancive që ia siguron Kushtetuta dhe jurisprudenca e kësaj gjykate. Në këtë drejtim nuk bëhet pengesë as Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut. Kjo e fundit vendos standardet e domosdoshme dhe kufirin minimum të mbrojtjes së të drejtave e lirive themelore, por ajo nuk pengon që shtetet anëtare të vendosin standardet e kufij më të përparuar për mbrojtjen e të drejtave.

2. Përfaqësuesi i Kuvendit pretendoi gjithashtu se kushtetutshmëria e dekretit të Presidentit, si një akt me karakter individual, nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata Kushtetuese sepse verifikimin e shkaqeve të shkarkimit të Prokurorit të Përgjithshëm ka të drejtë ta bëjë vetëm Presidenti i Republikës.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se sipas nenit 149/2 të Kushtetutës, Presidenti i Republikës është organi që vendos për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm kur arrin në përfundimin se ky i fundit ka shkelur Kushtetutën ose ka bërë shkelje të rënda të ligjit gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, ka kryer akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën e figurën e prokurorit ose ka paaftësi mendore a fizike. Në këto raste, Presidenti i Republikës (ashtu si edhe Gjykata Kushtetuese në rastet e parashikuara në nenet 90/3, 128 e 140 të Kushtetutës, kur shqyrton shkaqet e shkarkimit të Presidentit të Republikës, të anëtarit të Gjykatës Kushtetuese e të anëtarit të Gjykatës së Lartë), verifikon jo vetëm kushtetutshmërinë e procedurës së ndjekur për shkarkimin e tyre, por edhe bazueshmërinë në Kushtetutë të shkaqeve të shkarkimeve, pra i futet çështjes në themel. Ndërsa në rastin në shqyrtim, Gjykata Kushtetuese, duke u bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës në lidhje me interpretimin e bërë në

vendimin e saj nr.76, datë 25.4.2002, verifikon pretendimin e individit se gjatë zbatimit të procedurës për shkarkimin e tij nga Kuvendi e Presidenti nuk është respektuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, sipas të cilit liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të tillë ligjor. Në këtë rast Gjykata Kushtetuese nuk i hyn themelit të çështjes, pra vlerësimit të shkaqeve të shkarkimit dhe as shfuqizon aktet e Kuvendit e Presidentit për çdo shkelje të procedurave, por i shfuqizon ato vetëm kur konstaton se nuk janë respektuar parimet procedurale në atë masë që të sigurojnë respektimin e së drejtës për një proces të rregullt në kuptimin kushtetues.

II

Kërkuesi pretendoi se Kuvendi dhe Presidenti i Republikës kanë zhvilluar proces jo të rregullt, pasi nuk e kanë njohur me provat/faktet që përligjin shkaqet kushtetuese të shkarkimit nga detyra. Sipas tij, provat nuk i janë nënshtruar hetimit nga Komisioni Hetimor, por janë konsideruar të mirëqena.

Përfaqësuesi i Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me këtë pretendim, parashtroi se Kuvendi ka respektuar kërkesat e një procesi të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues gjatë procedurës së propozimit për shkarkimin, ashtu siç parashikon Rregullorja e Kuvendit. Sipas tij, kërkuesi është njohur me provat e dërguara zyrtarisht më parë nga organet që përmenden në raportin e Komisionit Hetimor. Veç kësaj, ky raport i është dërguar paraprakisht kërkuesit dhe kundër pretendimeve e provave që përmendeshin në të ai u mbrojt në seancën plenare të Kuvendit.

Gjykata Kushtetuese konstaton se, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, kërkuesi është ftuar të marrë pjesë në mbledhjen e Komisionit të Kuvendit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në datën 17.10.2007, datë në të cilën u shqyrtua kërkesa e 28 deputetëve (1/5 e të gjithë deputetëve të Kuvendit) për ngritjen e një komisioni hetimor për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm. Me kërkesën e kërkuesit, Komisioni ka pranuar shtyrjen e seancës dhe në datën 22.10.2007 kërkuesi ka parashtruar pretendimet e tij para këtij Komisioni. Për shqyrtimin e çështjes nga ky Komision, kërkuesi nuk pati ndonjë pretendim.

Pretendime për veprime e qëndrime antikushtetuese kërkuesi paraqiti sidomos për mënyrën e shqyrtimit të çështjes në Komisionin Hetimor.

Rezultoni se Komisioni Hetimor është ngritur me vendimin nr.135, datë 25.10.2007 të Kuvendit, pas propozimit të Komisionit Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Me shkresën nr.3356, datës 26.10.2007 kërkuesi është ftuar të dëgjohet në seancën dëgjimore të Komisionit Hetimor të datës 29.10.2007. Në atë seancë kërkuesi nuk ka marrë pjesë dhe me shkresën nr.2661/5, datë 29.10.2007, me cilësinë e Prokurorit të Përgjithshëm, i kthen përgjigje Komisionit duke i theksuar se ai është dëgjuar në Komisionin e Kuvendit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut “jo vetëm për kushtetutshmërinë e procesit, por edhe për anën substanciale të tij”. Sipas shkresës atij nuk i është vënë në dispozicion ndonjë material tjetër shtesë që të përmbajë fakte që do të jenë objekt hetimi nga komisioni, prandaj kërkon të vihet në dijeni paraprakisht për faktet mbi të cilat janë arritur konkluzionet e paraqitura në kërkesën për shkarkim. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Komisioni Hetimor, me shkresën nr.3356/3, datë 31.10.2007, i kthen përgjigje se veprimtaria e Komisionit Hetimor “ka qenë transparente”, “seancat, diskutimet, materialet, raportet janë bërë publike e të disponueshme për të gjithë” dhe se “mund të konsultohet me të gjitha materialet në ambientet e Kuvendit” duke i rezervuar edhe të drejtën e tij të dëgjohet në seancë plenare “lidhur me kërkesën, provat e shqyrtuara nga Komisioni Hetimor dhe raportin e tij përfundimtar”.

Duke u nisur sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se Komisioni Hetimor nuk i ka mohuar kërkuesit të drejtën për t’u njohur me materialet e shqyrtuara nga Komisioni dhe as të drejtën për të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit, për të paraqitur provat e veta dhe për të provuar pretendimet e tij. Në respektim të Rregullores së Kuvendit, të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit”, si dhe të rregullave të Kodit të Procedurës Penale, kërkuesi duhej t’i përgjigjej ftesës që i bëri Komisioni Hetimor për t’u dëgjuar prej këtij të fundit, ku do të njihej më mirë dhe me provat e administruara nga Komisioni. Jo vetëm kaq, por ai ishte i njohur më parë me shkaqet e problemet për të cilat grupi nismëtar i deputetëve do të bënte hetime dhe lidhur me këto, edhe me një pjesë të mirë të dokumenteve mbi të cilat ky grup i bazonte shkaqet për shkarkim.

Konstatohet gjithashtu se Kryetarja e Kuvendit, me shkresën nr.3457/1, datë 2.11.2007 i ka dërguar kërkuesit kopjen e raportit përfundimtar të Komisionit Hetimor dhe me shkresën nr.3464, datë 2.11.2007 e njofton kërkuesin për të drejtën që ka për t'u dëgjuar në seancën plenare të Kuvendit më datë 5.11.2007. Në këtë seancë, kërkuesi pranoi të parashtrojë pretendimet e tij para deputetëve të Kuvendit për problemet që ngriheshin në raportin e Komisionit Hetimor. Nga përmbajtja e dokumenteve të mësipërme, nga pretendimet e parashtruara prej kërkuesit në Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, nga raporti përfundimtar i Komisionit Hetimor dhe sidomos nga fjala që ka mbajtur kërkuesi në Kuvend del qartë se ai ishte në dijeni jo vetëm për akuzat e ngritura kundër tij, por edhe për përmbajtjen e provave mbi të cilat Komisioni mbështeste konkluzionin e vet për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm. Për më tepër, me këto prova, të specifikuar edhe në raportin përfundimtar të Komisionit, Prokurori i Përgjithshëm ishte njohur nga korrespondenca dhe rrugët e tjera të komunikimit të këtij organi me ministrinë dhe organet e tjera. Kështu, nga raporti që Komisioni Hetimor Parlamentar ka paraqitur në Kuvend dhe që i është dërguar para seancës plenare edhe kërkuesit rezulton, se Komisioni i ka kërkuar Kuvendit miratimin e raportit për t'i propozuar Presidentit të Republikës shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm për shkak të mosekzekutimit të urdhër arresteve ndërkombëtare (të cilat kanë kaluar në prokurori nëpërmjet rrugëve institucionale); për indiferencën apo përkrahjen e lirimit të të dënuarve për vepra penale të rënda “për shkaqe manipulative e abuzive” ku prokurorët kanë marrë pjesë në gjykim dhe se Prokurori i Përgjithshëm “është vënë në dijeni nga Ministri i Drejtësisë me shkresën e datës 11.4.2007” “Për mosveprim të prokurorisë në rastin e çështjeve të pushuara nga gjykata” apo “arkivimit të padrejtë të disa procedimeve për vepra penale të rënda” të marra nga raporti i Ministrisë së Drejtësisë “Analiza statistikore e veprimtarisë së prokurorisë për vitin 2006”. Shkaqet si më sipër dhe dokumentet mbi të cilat Komisioni Hetimor mbështet arsyetimet e veta jo vetëm janë përmendur në raport, por ishin të njohura apo disponoheshin edhe nga organi i prokurorisë.

Nga fjala e kërkuesit në Kuvend, si dhe nga shkresat e datave 29.10.2007 e 16.11.2007 që kërkuesi i ka dërguar Presidentit të Republikës, del se kërkuesi jo vetëm është njohur me problemet e dokumentet ku mbështetet Komisioni i Kuvendit, por ka dhënë dhe përgjigje të hollësishme në Kuvend lidhur me shkeljet e pretenduara në raport, duke i kundërshtuar ato si në aspektin faktit, ashtu edhe juridik. Veç kësaj, duke iu referuar dhe jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, rezulton se kjo Gjykatë nuk ka pranuar që për çdo shkelje e mangësi ta konsiderojë një proces gjyqësor apo administrativ të parregullt në kuptimin kushtetues. Në vendim e veta ajo (gjykata) ka afirmuar se parimi i barazisë së armëve, si dhe marrja e provave në mënyrë të ligjshme përbëjnë aspekte të rëndësishme të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, parashikuar nga neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në këtë drejtim, “detyra e Gjykatës është të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave, ka qenë i drejtë”.¹ Në qëndrimet e arsyetimet e veta, Gjykata Kushtetuese, ndërsa ka pranuar se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, ka pranuar gjithashtu se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit². Duke shkuar më tej rezulton se ajo nuk ka pranuar pretendimet për cenimin e primeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë ka plotësuar apo korrigjuar mangësitë e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor.

Në çështjen në shqyrtim, kërkuesi, pasi është njohur me raportin e Komisionit Hetimor, me pretendimet e këtij Komisioni për shkeljet e konstatuara prej tij dhe me provat ku ai bazohet, ka parashtruar në seancën plenare të Kuvendit pretendimet e tij pa kufizim kohe. Nga fjala e mbajtur prej tij del se ai ka dhënë përgjigje të argumentuara për të gjitha shkeljet që i atribuoheshin dhe lidhur me pretendimet e parashtruara prej tij janë zhvilluar diskutimet e debatet. Nuk rezulton që kërkuesit t'i kenë mohuar të drejtën për të paraqitur argumentet e provat e veta apo për të kundërshtuar akuzat.

III

Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin që nuk është i bazuar as pretendimi i kërkuesit se dekreti i Presidentit është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor. Presidenti i Republikës është njohur me pretendimet e kërkuesit në dy shkresat e lartpërmendura që ia ka dërguar kërkuesi. Duke i

1 Vendimi nr.11 datë 19.7.2005 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

2 (vendimi nr.25, datë 28.10.2005).

ballafaquar këto pretendime me të gjithë veprimtarinë dhe praktikën e ndjekur nga komisionet dhe Kuvendi, ai arriti në përfundimin se kërkuesi duhet të shkarkohet nga detyra. Ky qëndrim është në të njëjtën linjë me atë që theksohet në vendimin nr.75, datë 19.4.25002 të Gjykatës Kushtetuese, se “Presidenti i Republikës është organi kompetent i ngarkuar nga Kushtetuta për të kryer verifikimin nga pikëpamja kushtetuese të shkaqeve, si dhe të procedurave të ndjekura nga Kuvendi për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm”. Për Gjykatën Kushtetuese, që shqyrton një ankesë individuale për shkeljen e të drejtave kushtetuese për një proces jo të rregullt ligjor, objekt shqyrtimi nuk janë verifikimet e vërtetësisë, rëndësisë së shkeljeve dhe as interpretimi i ligjit në lidhje me shkakun e shkarkimit, pra me zgjidhjen në themel të çështjes. Në çështjen në shqyrtim, për Gjykatën Kushtetuese, objekt është respektimi edhe nga Presidentit i së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

Duke i parë problemet në këtë këndvështrim, dalin tej kontrollit kushtetues të kësaj gjykate verifikimi i pretendimeve të kërkuesit për pathemelësinë e akuzave lidhur me ekstradimet, me mosekzekutimin e urdhrave të arrestit etj. Verifikimi i tyre dhe nxjerrja e konkluzioneve lidhur me përgjegjësinë kushtetuese të Prokurorit të Përgjithshëm është kompetencë e Kuvendit dhe e Presidentit të Republikës, që buron nga neni 149 i Kushtetutës.

IV

Kërkuesi pretendoi gjithashtu se Kuvendi dhe Presidenti i Republikës gjatë procedurave për shkarkim, shkelën edhe parimet e tjera të procesit të rregullt ligjor si: respektimi i ndarjes së pushteteve, mosgjykimi dy herë i së njëjtës çështje, prezumimi i pafajësisë etj. Lidhur me këto ai pretendoi se kërkesa për shkarkim me të njëjtat palë, me të njëjtin objekt dhe me të njëjtin shkak ligjor i ishte nënshtruar njëherë shqyrtimit nga Komisioni Hetimor i mëparshëm dhe ishte refuzuar nga ish-Presidenti i Republikës.

Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve, Gjykata Kushtetuese ka dhënë përgjigje dhe ka përcaktuar kufijtë e kompetencave, në mosmarrëveshje midis Kuvendit dhe Prokurorisë në vendimet nr.26, datë 4.12.2006 dhe nr.12, datë 20.5.2008. Por, në çështjen në shqyrtim, pa hyrë në vlerësimin e konkluzioneve të Kuvendit, konstatohet se kontrolli i Komisionit Hetimor nuk i ka kapërcyer kufijtë e kompetencave të veta, përsa i përket konstatimit të mosveprimtarisë për lirin e të dënuarve për dënime të rënda apo analizës së drejtimeve kryesore të politikës penale.

Kërkuesi ka pretenduar gjithashtu se vendimi i Kuvendit, objekt shqyrtimi nr.12, datë 20.5.2008 është i njëjtë me vendimin e mëparshëm të tij nr.26, datë 4.12.2006 me të cilin i është propozuar Presidentit të Republikës të asaj periudhe shkarkimi i kërkuesit, propozim që nuk u pranua.

Lidhur me gjykimin dy herë për të njëjtën çështje, përfaqësuesi i Kuvendit pretendoi se ky problem është ngritur nga kërkuesi në kërkesën me objekt zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencave ndërmjet Prokurorit të Republikës e Kuvendit dhe do të marrë përgjigje në vendimin e Gjykatës Kushtetuese për këtë çështje.

Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi nga dokumentacioni rezulton se kemi të bëjmë me dy procese të ndryshme. Në çështjen në shqyrtim vërtetohet se Komisioni ka kontrolluar aktivitetin e Prokurorit të Përgjithshëm për periudhën pas refuzimit nga Presidenti i mëparshëm të propozimit të Kuvendit për shkarkimin e tij. Komisioni Hetimor dhe Kuvendi kanë konstatuar në këtë periudhë disa veprime e mosveprime që, sipas tyre, përbëjnë shkelje të përsëritura si: ekstradimi i të dënuarve për vepra penale, mosfillimi e pushimi i çështjeve etj. Ata kanë konstatuar gjithashtu disa veprime/mosveprime që jo vetëm nuk përbëjnë të njëjtat fakte, por në disa raste nuk kanë as të njëjtën bazë juridike siç janë lirimi i të dënuarve për dënime të rënda, apo urdhrave të arresteve ndërkombëtare.

V

Kërkuesi pretendon gjithashtu, se gjatë hetimit të zhvilluar nga Komisioni Hetimor i Kuvendit dhe deri te shpallja e dekretit të Presidentit të Republikës, atij i është mohuar e drejta kushtetuese për t’u prezumuar i pafajshëm, duke u cenuar njëkohësisht edhe parimi i gjykimit nga një organ i paanshëm. Si argument për të vërtetuar këtë pretendim ai parashtroi faktin që disa nga deputetët që kanë kërkuar ngritjen e komisionit të dytë hetimor janë po ata që janë përfshirë në përbërje të këtij komisioni apo të komisionit të mëparshëm hetimor, si dhe faktin që Presidenti i Republikës që dekretoi shkarkimin kishte votuar në shqyrtimin e mëparshëm nga Kuvendi për marrjen e vendimit të propozimit për shkarkimin e tij nga detyra.

Lidhur me këtë pretendim përfaqësuesi i Kuvendit parashtroi se neni 149 i Kushtetutës e

përcakton qartë raportin e Kuvendit me Prokurorin e Përgjithshëm, duke i dhënë Kuvendit kompetencën të japë pëlqimin për emërimin, si dhe të propozojë shkarkimin e tij. Presidenti është i vetmi organ që mund të vendosë shkarkimin dhe si i tillë, ai nuk mund të zëvendësohet në funksionin e tij.

Gjykata Kushtetuese e çmon të nevojshme të shprehë vlerësimet e saj lidhur dhe me natyrën e shqyrtimit të çështjeve të shkarkimit të funksionarëve nga Kuvendi e Presidenti, si dhe të raportit që këto organe kanë midis tyre.

Komisionet parlamentare, në rastet e shkarkimit të funksionarëve kushtetues, zhvillojnë procedura “quazi gjyqësore” dhe respektojnë parimet e procesit të rregullt ligjor për aq sa ua lejon mundësia e shqyrtimit për të marrë një vendim, i cili është me karakter politiko-administrativ dhe jo gjyqësor.

Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr.18/2003, është shprehur se në këto raste, Kuvendi duhet të respektojë parimin e prezumimit të pafajësisë, ndërsa në vendimin nr.75, datë 19.4.2002 ka pranuar gjithashtu se funksioni që kryen Kuvendi në rastet e verifikimit të shkaqeve për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm ndryshon nga gjithë veprimtaria e tij e zakonshme si një organ që miraton ligje. Ky proces, sipas atij vendimi, është “një proces gjykimi disiplinor dhe i ngjashëm me procedurat hetimore administrative, ka parimet e veta, të cilat lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e atyre shkaqeve konkrete që kanë shërbyer për organin kompetent për të marrë masën e shkarkimit nga detyra të gjyqtarit apo të prokurorit”.

Megjithatë, edhe në rastet e gjykimit të funksionarëve të lartë kushtetues parimet e prezumimit të pafajësisë dhe ai i paanësisë nuk mund të zbatohen si parime tipike klasike të proceseve gjyqësore, sepse Parlamenti qoftë në përbërjen dhe organizimin e vet, qoftë në veprimtarinë e funksionit e tij nuk ka si të jetë organ gjyqësor. Parlamenti, në një procedurë shkarkimi nuk ushtron pushtet gjyqësor, por një pushtet tjetër e të ndryshëm, që në mënyrë ekskluzive i është deleguar atij. Prandaj, ky organ mund të zbatojë parimin e paanësisë në një mënyrë tipike kushtetuese d.m.th. për aq sa nuk e pengon të ushtrojë kompetencat e veta për të nxjerrë një akt administrativ që ka njëkohësisht edhe një natyrë kushtetuese.

Në këndvështrim të neneve 2, 3 e 64 të Kushtetutës, Kuvendi përbëhet nga përfaqësues të popullit, ka një përbërje pluraliste politike dhe vendimet e tij merren me shumicën e votave. Kjo përbërje pluraliste politike konkretizohet edhe në përbërjen e komisioneve.

Prerogativa e Kuvendit për paraqitjen e propozimit për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe ajo e Presidentit të Republikës për të dekretuar shkarkimin e tij, të parashikuara në nenin 149 të Kushtetutës, realizohen nëpërmjet një procedure që disiplinohet edhe nga ligji nr.8891, datë 2.5.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve etimore të Kuvendit”, nga Rregullorja e Kuvendit dhe nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese, por në asnjë prej këtyre burimeve që disjunojnë këtë procedurë nuk ndalohet që deputetët që kanë kërkuar nisjen e një procedure shkarkimi, të mos jenë edhe anëtarë të komisionit parlamentar. Gjithashtu, në asnjë prej këtyre burimeve nuk ndalohet dhe nuk mund të ndalohet që të lartpërmendurit të mos marrin pjesë në votimin e raportit përfundimtar.

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për Presidentin e Republikës. Duke qenë organi i vetëm që vendos për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm, ai është njëkohësisht i pazëvendësueshëm në këtë vendimarrje dhe si i tillë në konkurrimin e parimit të ushtrimit të funksionit të organit shtetëror me atë të paanshmërisë, merr përparësi ai i kryerjes së funksionit kushtetues.

VI

Kërkuesi pretendon se vendimi i Kuvendit nr.141, datë 5.11.2007, që miratoi raportin e Komisionit Hetimor me propozimin për shkarkimin dhe dërgimin e tij Presidentit të Republikës është marrë në kundërshtim me nenin 60 të Rregullores së Kuvendit, në të cilën parashikohet se votimi i fshehtë bëhet për çështje që kanë të bëjnë me personat dhe se çdo votim i kryer në kundërshtim me të është i pavlefshëm.

Lidhur me këtë pretendim, përfaqësuesi i Kuvendit pretendoi se vendimi i Kuvendit nuk është marrë në kundërshtim me Rregulloren e Kuvendit dhe çështja në shqyrtim nuk duhet të interpretohet në lidhje me nenin 60 të Rregullores, por me nenin 114/3 të saj, ku parashikohet se raporti i Komisionit Hetimor që i propozon Kuvendit shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues miratohet nga Kuvendi me shumicën e parashikuar rast pas rasti në Kushtetutë.

Gjykata Kushtetuese vë në dukje se Rregullorja e Kuvendit është një akt, burimi i rezervuar i

së drejtës kushtetuese, që disiplinon procedurën për zhvillimin e punimeve të Kuvendit, organizimin e brendshëm, raportet midis vetë Kuvendit si tërësi e **organizimave** të tij të brendshëm, raportet e tij me organet e tjera kushtetuese etj. Një pjesë e dispozitave të Rregullores janë në përmbajtje të njëjta me dispozitat kushtetuese, ndërsa disa të tjera janë norma ekzekutive të normave kushtetuese, pra, që përcaktojnë rregullat se si vihen në jetë normat kushtetuese. Në këtë rast, Kuvendi është organi, që me rregullore, interpreton jo vetëm normat kushtetuese, por edhe normat e tjera të rregullores së tij në praktikën e rasteve konkrete. Në vendimin nr.75, datë 19.4.2002 edhe Gjykata Kushtetuese ka nënvizuar, se pavarësisht nga rregullimi në Kushtetutë apo në ligj i procedurave të shkarkimit të gjyqtarit apo prokurorit, një gjë e tillë nuk e pengon Kuvendin të adaptojë rregulla të veçanta për çdo rast konkret, apo për të gjitha rastet në tërësi, por gjithmonë duke respektuar parimin kushtetues të procesit të rregullt ligjor.

Nga procesverbali i seancës plenare të Kuvendit të Shqipërisë, i datës 5.11.2007, rezulton se janë shprehur pro miratimit të raportit të Komisionit për kontrollin në Prokurori dhe miratimin e shkarkimit 77 deputetë, që përbëjnë më shumë se gjysmën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Para votimit të raportit të Komisionit Hetimor në Kuvend është debatuar për mënyrën e votimit, duke u interpretuar nenet 60 e 114 të Rregullores së Kuvendit. Në këtë seancë është konkluduar se, meqë Kuvendi nuk është organ që vendos, por propozon shkarkimin, rasti i miratimit të raportit të Komisionit Hetimor për shkarkimin e anëtarit të organit kushtetues nuk do të bazohet në nenin 60/1 të Rregullores që parashikon votim të fshehtë për çështje që kanë të bëjnë me personat, por në nenin 114/3 të rregullores që parashikon rastet e miratimit të raporteve të komisioneve hetimore. Për këtë të fundit, nuk parashikohet mënyra e fshehtë e votimit.

Për sa më sipër, në kushtet kur Kuvendi ka bërë vetë interpretim të normave të rregullores së vet dhe kur këto norma nuk janë të parashikuara drejtpërdrejtë nga Kushtetuta, por i takojnë interpretimeve e diskrecionit të atij organi, Gjykata Kushtetuese nuk mund të arrijë në konkluzione se votimi i hapur i Kuvendit në këtë çështje përbën element të një procesi jo të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/c e nenit 134/1/f të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenin 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Vladimir Kristo (krejtari), Gjergj Sauli, Xhezair Zaganjori, Petrit Plloçi, Kristofor Peçi, Kujtim Puto

Anëtarë kundër: Fehmi Abdiu, Sokol Sadushi, Sokol Berberi.

MENDIMI I PAKICËS

Mendimi ynë është i kundërt me qëndrimin e mbajtur nga shumica në shqyrtimin e rastit të ankimit kushtetues të kërkuarit Theodhori Sollaku.

Pretendimet e kërkuarit lidhen me disa nga aspektet kryesore që përfshihen në konceptin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Në mënyrë të përmblëdhur, pretendimet e tij përqendrohen në këto drejtime kryesore:

- Komisioni Hetimor, Kuvendi dhe Presidenti i Republikës nuk e kanë njohur kërkuarin lidhur me provat apo faktet që përligjin shkaqet kushtetuese të shkarkimit të tij nga detyra e Prokurorit të Përgjithshëm.

- Komisioni Hetimor, Kuvendi dhe Presidenti i Republikës nuk kanë respektuar detyrimin kushtetues për t'i dhënë kërkuarit kohën e mjaftueshme për ta dëgjuar dhe për të përgatitur në mënyrë efektive mbrojtjen e tij.

- Gjatë hetimit të zhvilluar nga Komisioni Hetimor dhe gjatë procedurës së ndjekur nga Kuvendi dhe Presidenti i Republikës, është cenuar parimi i paanshmërisë dhe kërkuarit i është mohuar e drejta për t'u prezumuar i pafajshëm deri në shpalljen e vendimit përfundimtar.

Në gjykime të kësaj natyre, Gjykata Kushtetuese (Gjykata), në ushtrimin e funksionit të drejtësisë kushtetuese, ka detyrimin për të hetuar mbi të gjitha faktet e natyrës kushtetuese që përfshihen në juridiksionin e saj dhe për të konkluduar përfundimisht nëse, gjatë një procesi disiplinor (impeachment) ndaj një funksionari publik, është respektuar e drejta për një proces të rregullt ligjor nga organet e pushtetit publik.

Gjykata e ka analizuar gjerësisht në jurisprudencën e saj respektimin e standardit kushtetues të procesit të rregullt ligjor për të gjitha konfliktet që janë vendimtare për pozicionin juridik të një personi, qoftë ai edhe funksionar publik. Çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Mosrespektimi i standardit të procesit të rregullt ligjor zhvlerëson si procedurat, ashtu edhe vendimet e marra nga cilido organ (vendim i Gjykatës Kushtetuese (GJK) nr.76/2002).

Kjo Gjykatë ka theksuar në qëndrimet e saj se njohja paraprake e personit ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit me materialet që e ngarkojnë me përgjegjësi, argumentimi i shkeljeve që i atribuon, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën për një proces të rregullt ligjor (vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.75/2002).

Jurisprudenca kushtetuese shqiptare ka konkluduar se parimi i prezumimit të pafajësisë mund të cenohet jo vetëm nga gjyqtar apo gjykata, por edhe nga autoritetet publike (vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.18/2003; shih *Allenet De Ribemont kundër Francës*).

Gjykata është shprehur se Kushtetuta e ngarkon Kuvendin dhe me funksion kontrollues me synimin për të realizuar balancën midis pushteteve. Funksioni i kontrollit parlamentar nënkupton të drejtën e pushtetit ligjvënës për t'u informuar dhe për të realizuar mbikëqyrjen, brenda kufijve të përcaktuar nga Kushtetuta (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.11/2008). Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese është theksuar se parimet kushtetuese, veçanërisht ai i ndarjes e balancimit ndërmjet pushteteve, i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i prezumimit të pafajësisë, i paanshmërisë... përbëjnë standarde kushtetuese mbi të cilat ngrihen dhe funksionojnë komisionet hetimore parlamentare (vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.18/2003).

Pikërisht, referimi të këto standarde i disa fakteve kushtetuese që kanë dalë gjatë procedurës së shkarkimit të kërkuarit nga detyra e Prokurorit të Përgjithshëm, përbën dhe argumentin kryesor mbi të cilin është bazuar mendimi i pakicës.

Përderisa qëndrimi i pakicës është i kundërt me qëndrimin e mbajtur nga shumica, është e domosdoshme që faktet kushtetuese të analizohen me shumë kujdes për çdo fazë në të cilin ka kaluar procesi, me qëllim për të gjykuar përfundimisht mbi pretendimet e ngritura nga palët gjatë gjykimit kushtetues.

Procedura e ndjekur në fazën e hetimit nga Komisioni Hetimor Parlamentar.

Komisioni Hetimor Parlamentar "Për shqyrtimin e kërkesës për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm" është ngritur me vendimin nr.135, datë 25.10.2007 të Kuvendit të Shqipërisë.

Njoftimi për të realizuar të drejtën për t'u shprehur në Komisionin Hetimor, në seancën dëgjimore të ditës së hënë datë 29.10.2007, i është dërguar kërkuarit ditën e premte, me shkresën nr.3356, datë 26.10.2007.

Kërkuari i është drejtuar Komisionit Hetimor në datën 29.10.2007 dhe ka kërkuar që t'i vihehin në dispozicion të gjitha faktet dhe provat mbi të cilat mbështeteshin konkluzionet e kërkesës për shkarkim. Këtë kërkesë Komisioni Hetimor e ka konsideruar si një refuzim të kërkuarit për të dëshmuar.

Më datën 30.10.2007, kërkuari e ka ripërsëritur kërkesën për t'i vënë në dispozicion faktet dhe provat që konsideroheshin si shkelje e rëndë e ligjit, si dhe ka kërkuar praninë e një përfaqësuesi të tij

në këtë komision. Këto kërkesa nuk rezultojnë që të jenë përmbushur nga Komisioni Hetimor.

Në datën 31.10.2007 Komisioni Hetimor i është drejtuar kërkesit duke arsyetuar se ai ka refuzuar të dëgjohet dhe nuk e ka konsideruar pozitën e tij të njëjtë me pozicionin procedural të të pandehurit. Gjithashtu, Komisioni Hetimor e ka vlerësuar si tepër transparente veprimtarinë e tij, për arsye se materialet kanë qenë të disponueshme për cilindo dhe i ka rikujtuar kërkesit të drejtën për t'u dëgjuar në seancën plenare të Kuvendit.

Raporti voluminoz i Komisionit Hetimor i është dërguar Kuvendit para datës 2.11.2007, i cili me shkresën e po kësaj date, ka njoftuar se seanca plenare për shqyrtimin e kërkesës për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm do të zhvillohej më datën 5.11.2007. Në këtë datë, Kuvendi ka miratuar raportin e Komisionit Hetimor Parlamentar duke i propozuar Presidentit të Republikës shkarkimin nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm.

Nga renditja kronologjike e këtyre fakteve kushtetuese rezulton se Komisionit Hetimor Parlamentar i është nevojitur një periudhë 8 ditore (nga data e ngritjes së tij e deri në datën e paraqitjes së raportit në Kuvend), për të hetuar të gjithë veprimtarinë në shkelje të rëndë të ligjit të Prokurorit të Përgjithshëm dhe për t'i propozuar Kuvendit shkarkimin e tij nga detyra.

Hetimi në një kohë tepër të shkurtër i një funksionari të lartë të një organi kushtetues, në procesin ndaj të cilit nuk garantohen të drejtat kushtetuese të personit të vënë nën akuzë për shkelje të rënda të ligjit, të cilat lidhen me standardin e procesit të rregullt ligjor, përbën cenim të Kushtetutës prej vetë organeve më të larta të pushtetit shtetëror.

Respektimi i të drejtës së kërkesit Theodhori Sollaku për t'u njohur paraprakisht me materialet e çështjes nuk është thjesht vetëm një e drejtë për të, por përbën dhe një detyrim për Komisionin Hetimor që është marrë me hetimin e veprimtarisë së tij (neni 31, shkronja "a" e Kushtetutës, si dhe neni 6/3, shkronja "e" e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut).

E drejta e kërkesit për t'u njohur me të gjitha materialet dhe faktet në ngarkim të tij, nuk mund të përmbushet si rrjedhojë e parimit të transparencës apo të drejtës për t'i kërkuar dhe gjetur ato në arkivin e organit vendimmarrës. Është dhe mbetet detyrim ligjor i organit procedues për të vënë në dispozicion të të akuzuarit të gjitha faktet e provat mbi të cilat është bazuar procedimi ndaj tij.

Informimi i plotë dhe i saktë për akuzat e ngritura, si dhe për kualifikimin juridik të mundshëm, është kusht themelor për besueshmërinë e procesit dhe për përgatitjen e duhur të një mbrojtje efektive. Qëllimi i nenit 6, paragrafi 3, shkronja "b", të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut është të garantojë barazinë e armëve ndërmjet palës akuzuese dhe mbrojtjes, duke i krijuar mundësinë të akuzuarit të njihet me materialet, provat dhe rezultatet e hetimit për të përgatitur mbrojtjen efektive.

Realizimi i ushtrimit të së drejtës për një mbrojtje efektive lidhet jo vetëm me njohjen paraprake të fakteve e provave për të cilat kërkohet shkarkimi, por dhe me dhënien e kohës së mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes (neni 6, paragrafi 3, shkronja "b", e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut). Vlerësimi, nëse një kërkesë e tillë është përmbushur, varet nga konstatimi nëse informacionet kanë mbërritur tek i akuzuari me shpejtësi të mjaftueshme që ai të mund të përgatisë një mbrojtje të përshtatshme. Pasja ose jo e "kohës së mjaftueshme", në çdo çështje, varet nga rrethana të tilla si: natyra e pretendimeve të ngritura, shkalla e komplikimit të çështjes, faza e procesit në të cilën ndodhet çështja, insistimi i kërkesit për t'u mbrojtur vetë etj. E drejta e të akuzuarit për të pasur mundësitë e domosdoshme për përgatitjen e mbrojtjes, nënkupton që duhet të bëhet i mundur organizimi i mbrojtjes në mënyrën e duhur që t'i parashtrijë organit vendimmarrës argumentet themelore në mbrojtje të vet pa kufizime.

Respektimi i procesit të rregullt kërkon, ndër të tjera, dhe zhvillimin e një procesi kontradiktor. Personi i vënë nën akuzë ka të drejtë të kundërshtojë provat e paraqitura, të pyesë dëshmitarët e thirrur në seancat dëgjimore të Komisionit Hetimor, të kërkojë marrjen e provave apo thirrjen e dëshmitarëve të tjerë, etj. Respektimi i këtij aspekti të procesit të rregullt përbën jo vetëm një garanci për mbrojtjen e të drejtave të personit të vënë nën akuzë, por krijon mundësinë për vlerësimin, në mënyrë publike dhe transparente, të përgjegjësisë së Kuvendit në ushtrimin e kësaj kompetence që ia ka dhënë Kushtetuta.

Nga të dhënat që ndodhen në dosjen gjyqësore rezulton se Komisioni Hetimor Parlamentar është vënë në dijeni në mënyrë të vazhdueshme nga kërkesi Theodhori Sollaku për të gjitha kërkesat e sipërcituara, të cilat garantohen nga e drejta për një proces të rregullt ligjor, por që nuk janë vlerësuar si të drejta. Gjithashtu, Komisioni Hetimor nuk ka zhvilluar një proces kontradiktor sipas elementeve

të trajtuara më sipër. Bazuar mbi këto fakte kushtetuese pakica arrin në përfundimin se kërkuesit nuk i është respektuar e drejta për një proces të rregullt ligjor nga Komisioni Hetimor i ngritur me vendimin nr.135, datë 25.10.2007 të Kuvendit.

Procedura e ndjekur nga Kuvendi

Më datën 5.11.2007 (ditën e zhvillimit të seancës për miratimin e raportit të komisionit hetimor) kërkuesi Theodhori Sollaku, në respekt të garantimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, i kërkoi Kuvendit që t'i vinte në dispozicion të gjitha provat si dhe raportet e ardhura komisionit hetimor nga Ministria e Drejtësisë. Përmbajtja e plotë dhe integrale e provave mbi bazën e të cilave akuzohej Prokurori i Përgjithshëm, nuk rezultoi që t'i jenë bërë të njohura kërkuesit as nga Kuvendi. Në seancën plenare të datës 5.11.2007 ku është shqyrtuar raporti i Komisionit Hetimor parlamentar, Kuvendi e ka dëgjuar kërkuesin.

Lind pyetja: A e ka plotësuar Kuvendi detyrimin kushtetues për ta dëgjuar Prokurorin e Përgjithshëm?

Nga pikëpamja formale – Po. Nga pikëpamja substanciale – Jo.

Një procedurë e tillë dëgjimore nuk plotëson kushtet elementare që lidhen me realizimin e të drejtës së mbrojtjes. E drejta për t'u dëgjuar nuk mund të zëvendësojë, por njëkohësisht as të njësohet me të drejtën e mbrojtjes. Të realizosh dëgjimin e personit që do të procedohet nuk do të thotë se organi e ka përmbushur edhe standardin kushtetues të mbrojtjes për të. E drejta për t'u mbrojtur është e ndërruar nga disa elemente të tjera, po aq thelbësore, që ndiqen gjatë një procesi ligjor, si:

- e drejta për t'u informuar brenda një afati sa më të shkurtër, në mënyrë të hollësishme për natyrën dhe për shkakun e akuzës;

- e drejta për të pasur kohën dhe mundësitë e domosdoshme për përgatitjen e mbrojtjes;

- e drejta për t'u mbrojtur vetë, ose me ndihmën e një mbrojtësi;

- e drejta për të marrë në pyetje, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës, etj.

Nëse nuk përmbushen në tërësinë e tyre këto standarde kushtetuese, atëherë dëgjimi i të akuzuarit nuk plotëson dhe as nuk e përmbush në mënyrë efektive të drejtën e tij për t'u mbrojtur.

Të gjitha prapësimet dhe kundërgargumentet e dhëna në fjalën e mbajtur nga kërkuesi Theodhori Sollaku në Kuvend, janë kufizuar vetëm në përmbajtjen e raportit, por jo në analizën e hollësishme të fakteve e të dhënave konkrete që përfshihen në të. Nga kjo pikëpamje, kërkuesi nuk ka arritur të realizojë një mbrojtje efektive në kuptim të neneve 31, 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Procedura e ndjekur nga Presidenti i Republikës

Në kuptim të Kushtetutës, Presidenti i Republikës gjatë procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm ka për detyrë të verifikojë nëse:

- shkaqet e shkarkimit janë në përputhje me Kushtetutën (kontrolli i të cilave nuk përfshihet në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese), si dhe

- procedurat e ndjekura nga Komisioni Hetimor dhe Kuvendi kanë qenë në përputhje me standardin e një procesi të rregullt ligjor.

Pozicionin kushtetues të Presidentit të Republikës për verifikimin e respektimit nga Kuvendi të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese e ka analizuar në një mënyrë të detajuar dhe në një tjetër rast të ngjashëm me çështjen në shqyrtim.

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.76, datë 25.4.2002 (çështja A.Rakipi kundër dekretit të Presidentit të Republikës dhe vendimit të Kuvendit), ka përcaktuar një standard të procesit të rregullt ligjor gjatë procedurës verifikuese që ushtron Presidenti i Republikës. Në këtë vendim arsyetohet, ndërmjet të tjerave, se “kërkuesi është thirrur nga Presidenti para dekretimit të shkarkimit nga detyra, por nuk rezultoi që ai të jetë njohur më parë me materialin që përmbante shkaqet e shkarkimit të tij nga detyra apo që t'i jetë dhënë koha e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen, me qëllim që Presidenti i Republikës, në përputhje me Kushtetutën, të kishte mundësinë për të ushtruar kompetencat e tij vendimmarrëse ndaj vendimit propozues të Kuvendit.”

Ky arsyetim i Gjykatës Kushtetuese ka evidentuar standardin kushtetues që lidhet me detyrimin kushtetues të Presidentit të Republikës për të njohur më parë të proceduarin për shkarkim me materialin konkret në ngarkim të tij, si dhe me dhënien e kohës së nevojshme për të përgatitur një

mbrojtje sa më efektive.

Për rastin në shqyrtim, Presidenti i Republikës në datën 9.11.2007 i ka kërkuar Kuvendit të gjithë praktikën mbi të cilën ka operuar komisioni hetimor parlamentar, (procesverbalin e mbledhjes, si dhe materialet e Ministrisë së Drejtësisë e të Ministrisë së Brendshme). Pra, janë pikërisht këto materiale, të cilat kërkuesi Theodhori Sollaku i ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme t'i viheshin në dispozicion nga komisioni hetimor parlamentar dhe nga Kuvendi.

Nga dosja gjyqësore dhe nga deklaratimet në seancë plenare nuk rezulton që këto materiale t'i jenë vënë në dispozicion kërkuetit edhe nga Presidenti i Republikës, me qëllim që atij t'i krijohej mundësia të shprehej dhe të realizonte mbrojtjen përpara këtij organi vendimmarrës, që do të zgjidhte përfundimisht çështjen. Sipas shpjegimeve të përfaqësuesit të Presidentit të Republikës në seancën plenare të gjykimit kushtetues, mbrojtja e kërkuetit është përmbushur nëpërmjet fjalës që ai ka mbajtur në Kuvend.

Presidenti i Republikës, në rastin konkret është organi që zgjidh çështjen përfundimisht. Procedura që ndiqet përpara këtij organi, është një procedurë që kërkon domosdoshmërisht respektimin e standardit kushtetues të procesit të rregullt ligjor. Pas dëgjimit të kërkuetit nga Kuvendi, ka një tjetër procedurë vendimtare në të cilën duhen përmbushur në të njëjtën mënyrë të gjithë elementet e procesit të rregullt ligjor.

Kërkuetin Theodhori Sollaku e ka dëgjuar Kuvendi, pra organi propozues, por jo Presidenti, i cili është organi që vendos përfundimisht për funksionarin publik, sipas një procedure të rregullt ligjore. Pra, e drejta për t'u dëgjuar përpara organit që do të vlerësojë përfundimisht mbi shkaqet e shkarkimit, nuk konsiderohet e përmbushur, nëse ky organ nuk e dëgjon vetë të akuzuarin, aq më tepër kur një kërkesë e tillë është përsëritur në mënyrë të vazhdueshme. Ky është qëndrimi që ka mbajtur Gjykata Kushtetuese dhe në një rast të ngjashëm me rastin në shqyrtim, kur ka shfuqizuar si antikushtetues dekreten e Presidentit të Republikës për shkarkimin nga detyra të ish-Prokurorit të Përgjithshëm Arben Rakipi (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.76/2002).

Sipas këtij standardi kushtetues të analizuar gjerësisht nga Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, Presidenti i Republikës, si organi vendimtar që zgjidh përfundimisht çështjen, duhet të përmbushë një procedurë korrekte në drejtim të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Ky standard kushtetues kërkon vënien në dispozicion të të gjitha materialeve që e informonin kërkuetin Theodhori Sollaku në mënyrë të hollësishtme për thelbin dhe shkakun e akuzës së ngritur, dhënien e kohës së nevojshme dhe të mundësive të domosdoshme për të përgatitur mbrojtjen në mënyrë efektive, si dhe dëgjimin e tij për të gjitha akuzat e ngritura. Elementet e këtij standardi kushtetues nuk rezultojnë të jenë përmbushur nga ana e Presidentit të Republikës dhe, për rrjedhojë, e drejta e kërkuetit për një proces të rregullt ligjor është cenuar edhe në këtë fazë të procesit.

Parimi i prezumimit të pafajësisë

Në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese është theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë është një ndër parimet kushtetuese thelbësore që duhet respektuar në ngritjen dhe ushtrimin e veprimtarisë së komisioneve hetimore, pasi lidhet me garantimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Ky parim është pranuar se mund të cenohet jo vetëm në procedimet gjyqësore nga gjyqtarë apo gjykata, por edhe në procedimet administrative nga autoritetet publike.

Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut e ka interpretuar këtë parim dhe e ka shtrirë tej procesit penal, duke i dhënë një rëndësi të veçantë garantimit të të drejtave të parashikuara në Konventë në mënyrë praktike dhe efektive, jashtë kontekstit teorik apo iluziv. Ky parim mishërohet edhe në lidhje me zbatimin e nenit 6, paragrafi 2, të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Gjatë aktivitetit hetimor, komisionet parlamentare ushtrojnë edhe kompetenca gjyqësore apo *quasi* gjyqësore. Ato janë të pajisura nga ligji me pushtete të njëjta me ato të organeve të hetimit e të gjykimit në drejtim të marrjes së provave. Në këtë kuptim, komisionet hetimore duhet të garantojnë plotësisht këtë parim, duke mos e trajtuar apriori personin e vënë nën akuzë si fajtor (vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr.18, datë 14.5.2003).

Thelbi i këtij parimi nënkupton se vendimmarrësit nuk duhet ta gjykojnë çështjen me bindjen se i akuzuari e ka shkelur ligjin, për të cilin akuzohet. Barra e provës rëndon mbi akuzën dhe çdo akuzë duhet interpretohet në favor të të akuzuarit. Nga ky parim rezulton se pala akuzuese është e detyruar të informojë të akuzuarin për akuzat e bëra, me qëllim që ky të përgatisë dhe të paraqesë në mënyrën e duhur argumentet në mbrojtje të tij. Jurisprudenca kushtetuese ka konkluduar se ky parim

shkelet në qoftë se vendimmarrësit prononcohen rreth fajit, pa ia provuar këtë fillimisht të akuzuarit në përputhje me ligjin dhe sidomos, pa i mundësuar ushtrimin e të drejtës së mbrojtjes.

Gjithashtu, kërkesa që organi procedues i bën të akuzuarit për të dhënë shpjegime në mungesë të provave të drejtpërdrejta, nënkupton zhvendosjen e barrës së provës nga akuza te mbrojtja, duke shkelur në këtë mënyrë parimin e prezumimit të pafajësisë. Pra shkelja e parimit të prezumimit të pafajësisë shkon drejtpërdrejt në disfavor të të drejtës së mbrojtjes.

Gjatë procedurës së ndjekur për shkarkimin e kërkuarit nga detyra e Prokurorit të Përgjithshëm, që nga iniciimi i kërkesës për ngritjen e komisionit hetimor, në procedurën e ndjekur nga vetë Komisioni Hetimor, nga Kuvendi dhe më pas nga Presidenti i Republikës konstatohet se ky parim kushtetues nuk është respektuar.

Nga të dhënat në dosje rezulton se përpara ngritjes së Komisionit Hetimor dhe më pas gjatë veprimtarisë së tij, kërkuari, i proceduar për shkarkim, është vënë në pozitën e një personi, të cilit i janë provuar akuzat për shkelje të rëndë të ligjit, përpara se të arrihej në një vendim përfundimtar nga ana e Kuvendit. Kjo provohet:

- nga fakti se firmëtarët e nisjes së procedurës së shkarkimit janë shndërruar në anëtarë të Komisionit Hetimor për hetimin e paanshëm të të akuzuarit;

- nga përmbajtja që ka kërkesa për ngritjen e Komisionit Hetimor Parlamentar “Për shqyrtimin e kërkesës për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të Prokurorit të Përgjithshëm”, në të cilën konkluzioni për shkelje të rëndë të ligjit është nxjerrë përpara kryerjes së hetimit parlamentar;

- nga mosvënia në dispozicion e materialeve mbi të cilat është ngritur thelbi dhe shkaku i akuzës për shkelje të rëndë të ligjit;

- nga mosdhënia e kohës së nevojshme për realizimin e të drejtës së mbrojtjes;

- nga mosdëgjimi dhe mosushtrimi i të drejtës së mbrojtjes në mënyrë efektive;

- nga koha e pamjaftueshme (më pak se një javë) mbi të cilën Komisioni hetoi, konkludoi dhe përpiloi raportin voluminoz mbi shkeljet e rënda të ligjit të kryera nga ish Prokurori i Përgjithshëm.

Bazuar në analizën e mësipërme të pretendimeve të kërkuarit Theodhori Sollaku, pakica është e mendimit se gjatë procedurave të ndjekura nga Komisioni Hetimor Parlamentar, Kuvendi dhe Presidenti i Republikës për shkarkimin e kërkuarit nga detyra e Prokurorit të Përgjithshëm, është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Anëtarë: Sokol Sadushi, Sokol Berberi, Fehmi Abdiu.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 6.10.2008
Doli nga shtypi më 6.10.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 48 lekë